



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 13 regjistër (JR)
Datë 07.09.2018

Nr. 14 i vendimit
Datë 09.07.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Luan Daci	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 09.07.2019, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 13, datë 07.09.2018, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Alma Brati.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë publike¹, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji Komisionerin Publik, i cili përfundimisht bazuar në nenin 66, germa “b” dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të

¹ Seancat janë zhvilluar më: 13.12.2018, 18.12.2018, 05.02.2019, 11.03.2019, 25.03.2019, 12.04.2019, 26.04.2019, 22.05.2019, 05.06.2019, 17.06.2019, 02.07.2019. Vendimi përfundimtar u shpall më datë 09.07.2019.

Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Brati, dhe shkarkimin e saj nga detyra, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit me përparësi, për shkak të kandidimit të saj për anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) në vitin 2007, me numër indeksi {***}. Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”) i ndryshuar, subjekti ka dorëzuar ndër vitet 2007 – 2016 deklaratat e pasurisë, si dhe deklaratën e pasurisë për efekt të rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016 (në vijim “deklarata *vetting*”), brenda afatit ligjor (dorëzuar më datë 28.01.2017).
3. ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016², i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar, në të cilin konkludon se:
 - i. deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe ka hartuar raportin përkatës, të deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 08.01.2018, duke konstatuar në përfundim përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.³
5. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe në përfundim i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar.⁴ Në analizë të këtij raporti dhe pasi hetoi denoncimet, relatori i çështjes pranë Komisionit nuk gjeti elemente që mund të ngrenë

² Shkresa nr. {***} prot., datë 09.11.2017.

³ Shkresa nr. {***} prot., datë 30.10.2017.

⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 21.12.2017.

dyshime për paaftësi të theksuara profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe i propozoi trupit gjykues që subjekti i rivlerësimit të klasifikohet si “i aftë”.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 32, datë 05.07.2018, ka vendosur: “[...] Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”.

6.1. Megjithatë, pasi hetoi në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, Komisioni arsyetoi se:

- i) subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarinë ndër vite, për sa u përket shtesave dhe pakësimeve nga të ardhurat, pasaktësi të cilat kanë ndikuar dhe në analizën financiare, përkatësisht për vitet 2009 dhe 2012;
- ii) subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi me dokumentacion aftësinë paguese të ish-bashkëshortit për pensionin ushqimor, si dhe marrjen e pensionit ushqimor nga ai;
- iii) subjekti i rivlerësimit ka mungesa të ardhurash në shuma të papërfillshme, të cilat janë rrjedhojë e mosdeklarimit të shtesave dhe pakësimeve nga të ardhurat ndër vite, përkatësisht për vitet 2011-2013 në shumën prej 22.797 lekë, si dhe në vitet 2014-2015 në shumën 39.749 lekë.

Në përfundim të gjetjeve të mësipërme, këto pasaktësi dhe mospërputhje nga ana e Komisionit nuk u gjykuan si shtysa që çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara apo fshehje të pasurisë, pasi “janë në shuma të vogla, që nuk ndikojnë ndjeshëm në nivelin e pasurisë apo të të ardhurave të ligjshme të subjektit, si dhe një pjesë e tyre ka qenë objekt hetimi edhe nga ana e ILDKPI-së në vitin 2014, nga i cili ka rezultuar që këto pasaktësi nuk kanë arritur nivel të mjaftueshëm për marrjen e masave të mëtejshme. Në këtë vlerësim u mbajt parasysh fakti që subjekti ka qenë i saktë në deklaratën *vetting*⁵.”

Më tej, Komisioni arsyetoi se pasaktësitë në deklarinë e viteve të kaluara nuk lidhen me deklarinë e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin e Komisionit, konkluzioni për “deklarim të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet kur vërtetohet se subjekti, sipas deklaratës *vetting*, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë, apo kur tenton të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë. Pavarësisht se ka pasur pasaktësi në deklarime apo mungesë të të ardhurave në momente të caktuara, përgjatë deklarinëve të pasurisë ndër vite, në vlerësimin e Komisionit, subjekti nuk ka pasur për qëllim të fshehtë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë dhe pasaktësitë e konstatuara në rastin në fjalë nuk cenojnë figurën e gjyqtarit apo besimin e publikut te drejtësia⁶. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke balancuar vlerën e pasaktësive të konstatuara në raport me provat e tjera të administruara gjatë hetimit, Komisioni konstatoi se subjekti ka arritur

⁵ Shih vendimin e Komisionit, faqe 29, paragrafi 3.

⁶ Shih faqen 30 të vendimit të Komisionit.

të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrim kryesor kushtetues.

6.2. Vendimi i mësipërm (nr. 32/2018) i Komisionit është bazuar në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale⁷. Më konkretisht, pasi ka administruar të tria raportet e vlerësimit – raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, raportin e DSIK-së dhe raportin e KLD-së – dhe pasi shqyrtoi provat dhe dëgjo i publikisht subjektin e rivlerësimit, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, Komisioni ka konkluduar sa vijon: [...] *Për vlerësimin e pasurisë: [...] Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*⁸

6.3. *Për kontrollin e figurës, sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit: “[...] konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtare”*⁹. Sipas raportit të përcjellë nga DSIK, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, dhe nuk ka informacion që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Hetimi administrativ nuk solli asnjë element për ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.

6.4. Për vlerësimin e aftësive profesionale, në analizë të raportit të vlerësimit të kryer nga KLD-ja, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti, Komisioni vlerësoi se mangësitë e konstatuara në vlerësimin profesional janë formale dhe nuk janë të asaj shkalle sa të cenojnë aftësitë profesionale të gjyqtarit; si rrjedhojë, subjekti ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

III. Shkaqet e ankimit

7. Komisioneri Publik ushtroi ankim¹⁰ ndaj vendimit të Komisionit nr. 32, datë 05.07.2018, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Alma Brati, duke kërkuar që, pas hetimit të plotë të kriterit të kontrollit të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, në përfundim të gjykimit të çështjes, Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), të vendosë ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit të Komisionit. Sipas Komisionerit, vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit nuk është në përputhje me përcaktimet kushtetuese dhe ligjore mbi kriterin e kontrollit të pasurisë, duke argumentuar se hetimi dhe analiza e fakteve nuk i përgjigjet aplikimit të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, për sa i përket subjektit në fjalë. Sipas Komisionerit Publik, mangësitë e konstatuara në hetimin e kryer nga Komisioni dhe në vlerësimin drejt të fakteve për kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, mund të rregullohen nga ana e Kolegjit dhe justifikojnë rishikimin e vendimit.

⁷ Shih nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

⁸ Shih faqen 30 të vendimit të Komisionit.

⁹ Shih faqen 31 të vendimit të Komisionit.

¹⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 14.08.2018.

8. Në konkluzionet përfundimtare, të parashtruara në seancën e datës 02.07.2019, mbështetur në parashikimet e nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, të neneve D, Ç dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati.

A. Shkaqet ankimore për vlerësimin e pasurisë

9. Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, paraqiten si më poshtë.

9.1. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament në Tiranë, referuar nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pikat 14, 30 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk ka hetuar dhe administruar asnjë provë mbi burimin dhe ligjshmërinë e huas në shumën 25.000 euro dhe dhurimit të shumës 1.800.000 lekë, që ka shërbyer për shlyerjen e huas. Në të dyja rastet, Komisioni është mjaftuar me gjendjen e faktit – pasjen e llogarive bankare nga ana e personave të lidhur dhe deklaratat noteriale të dorëzuara nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

9.2. Për shumën që në total arrin 3.160.000 lekë, përfituar nga subjekti si e ardhur nën regjimin ushqimor, Komisioni nuk ka hetuar burimin dhe ligjshmërinë e tyre. Këto të ardhura janë deklaruar, por nuk ka asnjë dokument provues mbi vërtetësinë dhe ligjshmërinë e tyre. Ky fakt ndikon negativisht në analizën financiare për sa u përket likuiditeteve dhe pasurive të subjektit të rivlerësimit.

9.3. Subjekti i rivlerësimit ka qenë i pasaktë dhe ka kryer deklarim të rremë që prej deklarimit të parë të interesave privatë e në vijim, reflektuar edhe në deklaratën *vetting*, në kundërshtim kjo me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016.¹¹

9.4. Komisioni nuk ka hetuar burimin e ligjshëm të huas prej 3.200 eurosh, marrë prej subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e kredisë së marrë në vitin 2002 për rikonstruksionin e banesës në Durrës. Komisioni nuk ka hetuar shkakun e mospërputhjes midis sipërfaqes truall të banesës në Durrës, regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëpronarëve të tjerë, me sipërfaqen e tjetërsuar në kontratë.

10. Nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se kontrolli i kriterit të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit bazohet në analizën juridiko-financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur me të, të cilat duhet të vërtetohen me anë të dokumenteve zyrtare nga institucione publike e private dhe dokumenteve të dorëzuara nga vetë subjekti, nga deklaratimet periodike të interesave privatë dhe nga deklaratat *vetting*, për të kontrolluar nëse subjekti ka bërë deklarim të mjaftueshëm dhe të saktë, në përputhje me kërkesat ligjore. Ky kontroll, sipas Komisionerit Publik, duhet të përfshijë

¹¹ Shih faqen 5, pika 12.3 e ankimit të Komisionerit Publik në: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/08/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-32-dat%C3%AB-5.7.2018-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-znj.-Alma-Brati.pdf>.

verifikimin e llogarive bankare dhe gjendjes së tyre, përmbushjen e detyrimeve tatimore/financiare, ligjshmërinë e likuiditeteve të deklaruara si gjendje *cash*, llogarive bankare, asetet pasurore, burimin dhe ligjshmërinë e krijimit dhe veprimet juridike për disponimin e tyre, ndër të tjera.

11. Në seancën gjyqësore të datës 05.06.2019, Komisioneri Publik deklaroi heqjen dorë nga shkaku i ankimit, lidhur me saktësimin e sipërfaqes së truallit në bashkëpronësi për pasurinë që ndodhej në Durrës dhe me shumën në vlerën 3200 euro, të marrë nga subjekti i rivlerësimit për mbylljen e kredisë, me qëllim rikonstruksionin e banesës në Durrës. Ndërkohë, po në atë seancë, Komisioneri Publik konfirmoi që u qëndronte shkaqeve të ankimit që lidheshin me koston e rivlerësimit të pasurisë në Durrës, të përballuar nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj, si dhe:
 - i) shkakut të parë – hetimin e burimit të ligjshëm të huas në vlerën 25000 euro dhe pamundësisë së znj. E.B. për t'i dhuruar shumën prej 1.800.000 lekësh që ka shërbyer për shlyerjen e kësaj huaje dhe vërtetimin se si subjekti i rivlerësimit ka arritur të kursejë shumën 1.700.000 lekë;
 - ii) shkakut të dytë – lidhur me shumën prej 3.160.000 lekësh, të përfituar si pension ushqimor për të cilin Komisioni nuk ka hetuar burimin dhe ligjshmërinë e tyre.
12. Në parashtrimet përfundimtare¹², Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti që me prova dhe argumente bindëse, të provojë të kundërtën dhe nuk rrëzoi asnjë prej shkaqeve të ankimit. Komisioneri Publik arsyeton se në konsideratë të kërkimeve dhe prapësimeve të palëve, pranimit dhe vlerësimit tërësor të provave gjatë hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor të Kolegjit, zhvillimi i këtij procesi vijoi në respektim të dispozitave kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016. Gjatë gjithë procesit, subjektit të rivlerësimit iu garantua e drejta për një proces të rregullt ligjor, si dhe iu dha mundësia të provonte të kundërtën për secilin shkak ankimi. Treguesit e analizës financiare të Kolegjit paraqiten negativë dhe, duke veçuar disa vite në të cilat deklarohen kursime *cash*, hua, dhurim dhe blerje pasurie, konstatohet se në vitin 2014 diferenca negative është në vlerën 607.505 lekë, në vitin 2015 diferenca negative është në vlerën 1.444.602 lekë dhe në vitin 2016 është në vlerën 2.768.193 lekë. Si rrjedhojë, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi dhe me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara, të cilat më pas (shuma 1,7 milionë lekë) kanë shërbyer për shlyerjen e huas. Në vështrim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i njëjti fakt rezulton edhe lidhur me ligjshmërinë e burimit të deklaruar për shumën e dhuruar prej 1,8 milionë lekësh nga nëna e subjektit, që është përdorur për shlyerjen e huas prej 25.000 eurosh. Kjo hua rezulton e marrë në vitin 2015 dhe është deklaruar e shlyer plotësisht në vitin 2016. Për sa më lart, Komisioneri Publik argumentoi se bazuar në kërkesat e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe likuiditetet e deklaruara, e rrjedhimisht në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Në përfundim, Komisioneri Publik kërkoi

¹² <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/08/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-2.7.2019.pdf>

ndryshimin e vendimit nr. 32, datë 5.7.2018, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

IV. Shpjegimet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit

13. Përkundër sa Komisioneri Publik parashtron, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij theksoi se, pasi të vlerësohen të gjitha argumentet dhe provat shkresore të depozituara, referuar nenit D të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, prej tij janë deklaruar pasuritë që disponon, ligjshmëria e burimit të tyre dhe çdo kriter që parashikon ky detyrim. Në përfundim, subjekti kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

13.1. Në seancat dëgjimore të zhvilluara në datat: 13.12.2018, 18.12.2018, 05.02.2019, 11.03.2019, 25.03.2019, 12.04.2019, 26.04.2019, 05.06.2019, 17.06.2019, 02.07.2019, përkundër shkaqeve të ankimit nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit parashtroi se:

i) *Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë* apartament banimi¹³, me adresë rruga “{***}”, Tiranë, blerë me kontratë shitjeje me rezervë¹⁴, datë 09.09.2015, me vlerë 80000 euro, nga subjekti është deklaruar:

1. kontratë kredie [me nr. {***} rep., nr. {***} kol.] datë 23.09.2015, mes Alpha Bank Albania dhe [huamarrëses] Alma Brati, me vlerë kredie 7.000.0000 lekë, e konvertuar në shumën 50.000 euro;¹⁵
2. kursime nga të ardhurat në vite në vlerën 5.000 euro;
3. hua e dhënë nga tezja, znj. D.P., në vlerën 25.000 euro, për të cilën janë depozituar deklaratat noteriale të datës 20.02.2016 dhe 26.01.2018, si dhe transfertat bankare nga Banka Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”), në vitin 2015.¹⁶

Subjekti i rivlerësimit parashtroi se nuk ka pasur për qëllim deklarimin e rremë apo fshehje të pasurisë, siç pretendon Komisioneri Publik, dhe ka arritur të provojë ligjshmërinë e burimit të depozitës nga është dërguar transferta bankare në formën e huas prej 25.000 eurosh nga tezja e saj, znj. D.P., pasi:

1. marrëveshja me tezen D.P. ka qenë që detyrimi në shumën 25.000 euro të kthehej brenda 30 ditëve pasi të shitej shtëpia në bashkëpronësi në Durrës;
2. detyrimi është deklaruar dhe veprimet janë kryer nëpërmjet transaksioneve bankare dhe aktit noterial, të cilët janë verifikuar nga Komisioni;
3. shuma prej 25.000 eurosh është shlyer me kursimet ndër vite, të cilat arritën shumën 1.700.000 lekë dhe shumën 1.800.000 lekë, dhuruar nga nëna [E.B.], e cila jeton prej vitesh me subjektin e rivlerësimit;

¹³ Apartamenti nr. {***}, kati {***}, me numër pasurie {***}, sipërfaqe 100,1 m².

¹⁴ Nr. {***}kontratë shitjeje.

¹⁵ Akte të vëna në dispozicion për ILDKPKI-në dhe për Komisionin.

¹⁶ Akte të vëna në dispozicion dhe të verifikuara nga Komisioni.

4. Komisioni hetoi dhe i rezultoi që D.P. kishte burime të ligjshme të depozituara në banka ndër vite, shumë më herët se t'i jepte subjektit huan;
5. nga verifikimet e Komisionit ka rezultuar se numri i llogarisë nga janë kryer transfertat rezulton në emër të znj. D.P. dhe bashkëshortes së djalit të saj, M.P.;
6. Komisioni nuk i kaloi asnjëherë subjektit të rivlerësimit barrën e provës për ligjshmërinë e të ardhurave të znj. D.P.. Të ardhurat janë konsideruar të rregullta dhe të ligjshme përderisa në funksion të detyrimeve që kanë bankat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, në respektim të parashikimeve ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, VKM-ja nr. 343, datë 08.04.2009¹⁷, si dhe akte të tjera që rregullojnë dhe përcaktojnë mënyrën se si duhet të vepronë bankat për transaksione apo depozita bankare të dyshimta, nuk ka pasur ndonjë veprim, referim apo konstatim për të provuar të kundërtën. Në rastin konkret, nuk rezulton që veprime të tilla të jenë ndërmarrë nga banka. Si rrjedhojë, depozita konsiderohet e pastër në funksion të ligjshmërisë së burimit;
7. subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimet e të ardhurave janë nga puna në emigracion – familjarët e tezes së saj kanë më shumë se 20 vite që jetojnë dhe punojnë në Itali. Për këtë qëllim, subjekti paraqiti akte shkresore që provojnë të ardhurat e znj. M.P. dhe bashkëshortit të saj, z. L.P..

ii) *Lidhur me pretendimin për hetim të ligjshmërisë së të ardhurave të nënës*, konkretisht për sa i përket dhurimit të shumës prej 1 800 000 lekësh, subjekti i rivlerësimit solli dokumente që në vlerësimin e tij provojnë se prindërit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar jetesën dhe kursimet. Të ardhurat e prindërve janë mbajtur pjesërisht në bankë dhe pjesërisht në shtëpi, dhe, në lidhje me to, renditen këto fakte:

1. vlera që përbën dhurimin nga nëna rrjedh nga kursimet në vite të prindërve;
2. i ati i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri z. F.B., ka qenë në marrëdhënie pune gjatë periudhës 1967-2005¹⁸, në detyrën e prokurorit të rrethit në qytetet {***}, {***}, {***}, {***}(1967-1993), në detyrën e shefit të krimeve në degën {***} (1993-1994), dhe si avokat i licencuar (1995-2005);
3. të dhënat e mbledhura nga organet tatimore nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme, pasi vetë ato institucione kanë pranuar se informacioni që disponojnë, sidomos në rrethe ku ka pasur trazira në vitet 1997-1998, nuk është i plotë. Gjithsesi, të dhënat janë mundur të provohen me prova shkresore¹⁹;
4. të ardhurat e periudhës 1999-2003 janë konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës;
5. përveç të ardhurave të babait, subjekti ka parashtruar edhe dokumentacion që provon të ardhurat e nënës, e cila ka qenë arsimitare nga viti 1968 derisa ka dalë në pension;
6. kursimet provohen edhe nga akti noterial i datës 04.04.2013, sipas të cilit z. H.B. i ka kthyer E.B. një hua të cilën e kishte marrë në vitin 2006;

¹⁷ Vendimi nr. 343, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”

¹⁸ Sipas prapësimeve, faqja 3 e materialit të regjistruar në KPA, me nr. {***}, datë 11.12.2018.

¹⁹ Në prapësimet e saj, të regjistruara me nr. {***}, datë 11.12.2018, në faqen 4, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, shprehet: “[...] Për më tepër, ajo që nuk ka mundur të provohet nga organet tatimore, provohet me prova shkresore (vendimet gjyqësore ku babai ka marrë pjesë si avokat, certifikata tatimore bashkëlidhur [...]).”

7. nga Komisioneri Publik është vënë në dyshim një marrëdhënie juridike për dhënie huaje në vlerën 4.000.000 lekë ndërmjet nënës dhe z. H.B. në vitin 2006, ndërkohë që prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë qenë subjekte deklaruese në kuptim të ligjit nr. 9049/2003. Ky veprim është kryer në mirëbesim për shkak të marrëdhënies miqësore familjare dhe është formalizuar me deklaratën noteriale datë 04.04.2013. Zoti H.B. në këtë dokument deklaroi se vlera prej 1.500.000 lekësh është kthyer në vitin 2011, ndërsa shuma prej 2.500.000 lekësh është kthyer në vitin 2013;
8. burimi i shumës së kthyer nënës së subjektit të rivlerësimit nga z. B. është i ligjshëm. Për të provuar këtë fakt janë vënë në dispozicion kontratat e shitjes së apartamenteve prej këtij individi [huamarrës] në vitet 2011 dhe 2012;
9. këto veprime kanë ndodhur në vitin 2006 kur prindërit e subjektit jetonin më vete dhe kishin ekonomi të veçantë. Në atë kohë, subjekti nuk ka qenë në marrëdhënie pune në organet e drejtësisë;
10. Komisioni konkludoi se znj. E.B. ka pasur burime të ligjshme për t'i dhuruar subjektit të rivlerësimit vlerën 1.800.000 lekë në vitin 2016;
11. burimi i të ardhurave për blerjen e ½ shtëpisë në qytetin e Durrësit kanë qenë kursimet e gjithë viteve të punës së babait [F.B.] për periudhën 1968-2003, që janë 36 vite punë në institucione shtetërore dhe 8 vite punë në profesionin e avokatit;
12. sipas subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Publik, nëna [E.B.] ka paguar vetëm qiranë e banesës, ndërkohë që për vitet 2007-2010 kredia është paguar prej saj²⁰, siç edhe është deklaruar dhe sqaruar në pyetjet e Komisionit. Në kushtet e një marrëdhënieje familjare të posaçme të afërt, dhurimi nuk është bërë me akt noterial. Pohimi i palëve është i mjaftueshëm, në kushtet kur ligji nuk e ndalon, konkretisht referuar nenit 80 të Kodit Civil.

iii) *Lidhur me pensionin ushqimor të marrë mbi bazën e vendimit të gjykatës të vitit 2007*, subjekti parashtron se pretendimi i ngritur nga Komisioneri Publik për mungesën e hetimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të ish-bashkëshortit, mungesën e një akti shkresor dhe tatimin e kësaj të ardhure, duke qenë se një pjesë e vlerës është përdorur për blerjen e makinës, nuk qëndron, pasi:

1. është deklaruar dhe provuar se shuma që ish-bashkëshorti duhet të paguante për detyrimin ushqimor për të dy fëmijët, për vitet 2007-2010, është paguar në vitin 2011 në *cash*. Ky fakt është pranuar edhe nga vetë bashkëshorti;
2. është deklaruar se me marrëveshje verbale është dakordësuar për rritjen e vlerës së kontributit në shumën 50.000 lekë në muaj, fakt ky i provuar me:
 - a) deklaratën noteriale të vitit 2017 nga ish-bashkëshorti [z. K. B.];
 - b) pohimin e ish-bashkëshortit kur është pyetur nga Komisioni. Akti shkresor është për efekte provueshmërie kur njëra palë mohon pohimin e palës tjetër;
 - c) parashikimin e një marrëdhënieje të tillë edhe nga neni 221 i Kodit të Familjes.

²⁰ *Kredia e vitit 2002 për rikonstrukcionin e shtëpisë në Durrës.*

3. nuk mund t'i ngarkohet barra e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave të ish-bashkëshortit dhe vlerën e pensionit ushqimor në kushtet e ekzekutimit të një vendimi gjykate të formës së prerë, detyruet për ish-bashkëshortin;
4. argumentin e dhënë nga Komisioneri Publik, i cili është hipotetik dhe i pabazuar në ligj, duke qenë se të ardhurat nga detyrimi ushqimor sipas ligjit nuk taten dhe se nëse pensioni do të paguhej çdo muaj, sipas vendimit të gjykatës, pjesa e vlerës e shtuar për blerjen e makinës do të ishte pjesë e kursimit personal;
5. të ardhurat janë të ligjshme e të justifikuara dhe nuk ka pasaktësi të tilla që ndikojnë në analizën financiare të viteve 2011-2015 dhe në konkluzionin e nxjerrë nga Komisioni.

iv) *Lidhur me pasurinë në bashkëpronësi në qytetin e Durrësit*, për të cilën Komisioneri Publik pretendon se nuk është hetuar lidhur me sipërfaqen e pronës dhe se është ndikuar prej saj, si punonjëse e Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme Durrës, subjekti i rivlerësimit sqaroi se:

1. pasuria është shtëpi dykatëshe, me sipërfaqe ndërtimi 85,34 m², sipërfaqe trualli 158 m², blerë në vitin 2002. Subjekti ka në pronësi vetëm ¼ e pasurisë;
2. pasuria është blerë në vitin 2002, vit në të cilin subjekti nuk ka qenë punësuar pranë Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme Durrës;
3. kontrata e shitjes është regjistruar në përputhje me parashikimet ligjore të kohës;
4. veprimet e noterit nuk janë përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit;
5. pasuria është poseduar dhe gëzuar prej vitit 2002 e në vijim, pa u shqetësuar apo cenuar në pronësi nga palët e treta, duke qenë se është pasuri e blerë nga bashkëpronarët F.B., E.B., Alma Brati dhe K.B.

v) *Lidhur me ligjshmërinë e vlerës prej 3500 eurosh, të marrë në vitin 2009*, subjekti i rivlerësimit parashtron se:

1. aktet e konfirmuara nga institucionet italiane provojnë ligjshmërinë e burimit të vlerës prej 3500 eurosh, të dërguar në nëntor 2009 me Western Union nga M.P., e verifikuar edhe nga ILDKPKI (pasqyruar në procesverbalin e datës 15.09.2014). Për të provuar ligjshmërinë, janë paraqitur të gjitha të ardhurat e saj nga viti 2000 deri në vitin 2017;
2. kjo vlerë është marrë për të mbyllur kredinë e marrë në vitin 2002 nga kredimarrësit F.B. dhe K.B.;
3. faktet janë konfirmuar nga [ish-banka amerikane] Intesa SanPaolo Bank, me kthimin e përgjigjes së datës {***}, sipas së cilës kredia e marrë nga F.B. dhe K.B. në vitin 2002 është shlyer plotësisht;
4. në deklaratat vjetore është pasqyruar detyrimi total i të gjithë kredimarrësve për çdo vit. Pavarësisht se subjekti nuk është kredimarrës, ka deklaruar për të qenë transparente, duke qenë se mbi pasurinë në bashkëpronësi ekziston një detyrim.

13.2. Për të mbështetur sa më sipër, subjekti i rivlerësimit paraqiti gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, dokumentet e mëposhtme.

1. Vërtetim për të ardhurat e përgjithshme nga Zyra Territoriale në {***}, Drejtoria Krahinore në {***}, Agjencia e Hyrjeve, mbi të ardhurat e përgjithshme të kërkuases M.P. (përgjigje e kërkesës 08.11.2018), për vitet tatimore 2000-2011, përkatësisht në vlerat bruto 22.326,00 €,

- 12321,00 €, 9019,00 €, 13099,00 €, 14381,00 €, 13207,00 €, 15265,00 €, 15944,00 €, 15138,00 €, 16918,00 €, 16137,00 € dhe 17.695,00 €.
2. Vërtetim për të ardhurat e përgjithshme nga Zyra Territoriale në {***}, Drejtoria Krahinore në {***}, Agjencia e Hyrjeve, mbi të ardhurat e përgjithshme të familjes së përbërë nga M.P., L.P. dhe O.H.P. (përgjigje e kërkesës 08.11.2018), për vitet tatimore 2012, 2013, 2014 dhe 2015, përkatësisht në vlerat bruto 50409,00 €, 31408,00 €, 28277,00 € dhe 32220,00 €.
 3. Vërtetim për të ardhurat e përgjithshme, nga Zyra Territoriale në {***}, Drejtoria Krahinore në {***}, Agjencia e Hyrjeve mbi të ardhurat e përgjithshme të kërkuases M.P. (përgjigje e kërkesës 08.11.2018), për vitet tatimore 2016 dhe 2017, përkatësisht në vlerat bruto 16224,00 € dhe 16001,00 €²¹.
 4. Kopje e kartës së identitet të znj. M.P. dhe z. L.P.
 5. Pasqyrat e të ardhurave të përfituara nga M.P., të nxjerra nga Agjencia e të Ardhurave, sipas formateve standarde për vitet 2011-2013 dhe 2014-2016.
 6. Vërtetim nga i njëjti institucion si më sipër²², sipas të cilit më datë 07.02.2019 nuk ekzistojnë në ngarkim të tatimpaguesit M.P., në njësinë administrative {***} – {***}, kartela/njoftime ende të papaguara ose të paguara pjesërisht.
 7. Deklaratat tatimore për L.P. për vitet 2012-2016, nga Agjencia e të Ardhurave, datë 02.04.2019, të nxjerra në rrugë elektronike më datë 11.04.2019.
 8. Mandat tërheqje parash, Western Union MCTN: {***}, datë 20.11.2009, ora 12:37, dërgues M.P., marrës Alma Brati, shuma e marrë – 1900,00 euro, vendi i dërgimit – Itali.
 9. Mandat tërheqjeje parash, Western Union MCTN: {***}, datë 21.11.2009, ora 4:28, dërgues M.P., marrës Alma Brati, shuma e marrë – 1.600,00 euro, vendi i dërgimit – Itali²³.
 10. Shkresë nr.{***} prot., A.T., datë 21.11.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {***}, nëpërmjet së cilës subjekti informohet se pasqyrimi i të ardhurave për F.B. për vitet 1993-1994 është i pamundur dhe institucioni nuk disponon të dhëna përpara periudhës 15.02.1998 për shkak të dëgjies nga shkatërrimit të trazirave të periudhës 1997-1998. Për vitet 1994-1997, referimi është sipas legjislacionit në fuqi të kohës për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve.
 11. Vërtetim nr. {***} prot., datë 08.11.2018, i Prokurorisë së Përgjithshme, sipas të cilit në periudhat kohore dhe për detyrat respektive F.B. ka marrë pagesat si vijon: a) për periudhën 01.03.1968 – 15.07.1975, ndihmësprokuror në Prokurorinë e Rrethit {***}, pagë referuese 720 lekë; b) për periudhën 15.07.1975 – 01.03.1993, prokuror në Prokurorinë e Rrethit {***}, {***} dhe {***}, pagë referuese përkatësisht 890 lekë, 920 lekë dhe 1020 lekë.
 12. Vërtetim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, [nr. {***} prot., datë 25.04.2019], sipas të cilit F.B. [nuk janë të evidentuara atësia dhe ditëlindja] ka punuar në degën e Punëve të Brendshme {***}, me detyrë zv/shëf i Policisë Hetimore nga data 01.03.1993 deri më datë 01.09.1994, kur ka dalë në lirim me reformën e forcave të armatosura.

²¹ Vërtetimet e lëshuara nga autoritetet italiane janë paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, të përkthyer, të noterizuara dhe të shoqëruara me vulë apostile, në përputhje me përcaktimet e Konventës së Hagës.

²² Agjencia e të Ardhurave, Zona Territoriale {***} - {***}.

²³ Mandatpagesat janë paraqitur në kopje origjinale.

13. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.05.2019, nga F.L., e cila deklaroi se F.B. në datën 01.03.1993 ka qenë shef i Policisë Hetimore pranë Komisarariatit të Policisë {***}, detyrë që e ka ushtruar deri më 01.09.1994.
14. Vërtetim nr. {***} prot., datë 09.10.2018, i Drejtorisë Rajonale Tatimore {***}, sipas të cilit, nga të dhënat e SIT-it dhe C@TS, vërtetohet që i ati i subjektit nuk rezulton i regjistruar dhe që të dhënat e biznesit të vogël janë informatizuar në vitin 2005, si dhe që arkiva e regjistrimit nuk ka dosje në emër të të njëjtit individ.
15. Certifikatë regjistrimi në Degën e Tatim Taksave të Rrethit {***} [nr. serial {***}, me kod fiskal {***}, person fizik], që vërteton regjistrimin e të atit të subjektit si avokat dhe periudhën kohore përkatëse 08.08.1996 – 31.12.1996.²⁴
16. Mandat arkëtimi²⁵ në vlerën 5.000 lekë, për çelje llogarie nga F.B., nr. llogarie {***}, Shkodër.
17. Shkresë [nr. {***} prot., datë 05.12.2018] nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {***}, bashkëlidhur së cilës janë dërguar 17 vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {***}, të dhëna në periudhën tetor 1997 – dhjetor 1998, për çështje në të cilat i ati i subjektit figuron si avokat mbrojtës.
18. Vërtetim që Banka Kombëtare Tregtare, Dega {***} është djegur më 13.03.1997 dhe 22.02.1998 dhe, si rrjedhojë, nuk posedohet asnjë dokument përpara këtyre datave, lëshuar nga vetë ajo bankë [nr. {***} prot., datë 05.04.2019].
19. Libreza e pagesës për taksat lokale, Bashkia Durrës, në emër të F.B., kodi {***}, për pagesën e tatimit për pasurinë dhe taksën e pastrimit, të kryer në datën 25.03.2003.
20. Autorizim administrativ nga Inspektorati Shtetëror i Punës, Dega {***} [nr. {***}] për person fizik F.B., për vitin 2003.
21. Certifikatë regjistrimi në organin tatimor Dega Tatime e Taksa e Rrethit {***} nga 01.01.2003 – 31.12.2003 si biznes i vogël²⁶, për biznesin e avokatisë.
22. Vërtetim nga Spitali Rajonal Durrës, datë {***}, lidhur me shkrimin e F.S.B. në këtë institucion, nga 30.12.2003 deri më datë 19.01.2004.
23. Shkresë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {***} [nr. {***} prot., datë 08.04.2019], bashkëlidhur së cilës, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, ndodhen kopjet e 41 vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2000 – dhjetor 2003, në të cilat F.B. ka qenë përfaqësues i palëve në gjykim.
24. Deklarimin për regjistrimin vjetor në sigurimin shoqëror të detyrueshëm (mod. 2), datë 25.03.2003, sipas së cilës z. F.B. deklaroi se ka qenë i regjistruar në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore Durrës, me nr. personal {***}, viti 2002, dhe për vitin 2003, duke filluar nga data 01.01.2003, do të ushtrojë aktivitetin e avokatit si person fizik.
25. Formular regjistrimi në IShP për vitin 2003 për procesin e licencimit të subjekteve, nr. {***}, datë 17.03.2003 (IShP Lokal Durrës);

²⁴ Shkresa referon regjistrimin me vendimin nr. {***}, datë 06.08.1996, të gjykatës, objekt veprimtarie avokat dhe periudhë e veprimtarisë 08.08.1996 deri më 31.12.1996, me datë krijimi 06.08.1996.

²⁵ Nr. {***}, datë 05.08.1996.

²⁶ Shkresa përmban edhe të dhënat që vijnë: NIPT {***}, kodi fiskal {***}, regjistruar në gjykatë me vendimin nr. {***}, datë 13.09.1999, data e regjistrimit në organin tatimor: 16.09.1999.

26. Vërtetim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale {***} [nr. {***} prot., datë 02.04.2019], i cili përcjell një akt verifikimi të vjetërsisë në punë para vitit 1994 dhe një fotokopje të librit të pagës të vitit 1966.
27. Shkresë e Drejtorisë së Arkivave Shtetërore Vendore, [nr. {***} prot., datë 21.05.2019], bashkëlidhur së cilës gjenden vendimet nr. {***}, datë 14.10.1976 dhe nr. {***}, datë 07.02.1983 të Komitetit Ekzekutiv i K.P. të Rrethit {***} për transferim të znj. E.B.
28. Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Lezhë, [nr. {***} prot., datë 08.04.2019], bashkëlidhur aktverifikimit të vjetërsisë në punë para vitit 1994, për znj. E.B., për pagesat e kryera për periudhën 01.01.1972 – 31.08.1976.
29. Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, për znj. E.B., ndarë në periudhat kohore si vijon me pagat bruto si më poshtë:
 - për vitet 1983-1985, ky institucion nuk ka të dhëna²⁷;
 - për vitin 1986, shuma e pagave bruto është 7.200 lekë;
 - për vitin 1988, shuma e pagave bruto është 7.440 lekë;
 - për vitin 1989, shuma e pagave bruto është 7.440 lekë;
 - për vitin 1990, shuma e pagave bruto është 7.440 lekë;
 - për vitin 1991, shuma e pagave bruto është 7.680 lekë;
 - për vitin 1992, shuma e pagave bruto është 11.916 lekë;
 - për vitin 1993, shuma e pagave bruto është 24.069 lekë;²⁸
 - për vitin 1994, shuma e pagave bruto është 52.659 lekë;
 - për vitin 1995, shuma e pagave bruto është 76.543 lekë
 - për vitin 1996, shuma e pagave bruto është 110.400 lekë
 - për vitin 1997, shuma e pagave bruto është 117.120 lekë,
 - për vitin 1998, shuma e pagave bruto është 145.344 lekë;
 - për vitin 1999, shuma e pagave bruto për muajt janar, shkurt, qershor dhe të raportit për muajt mars – maj është 30.899 lekë²⁹.
30. Vërtetim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale {***} [nr. {***} prot., datë 04.10.2018], sipas të cilit Shkolla e Artistike “{***}” ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për znj. E.B., për periudhën janar, shkurt, qershor 1999 përkatësisht 5.714 lekë, 2.857 lekë dhe 5.612 lekë;
31. Kopje të librezës së punës për znj. E.B., për punësimin e periudhës 01.09.1966 – 23.06.1999, si dhe për periudhën 23.06.1999 – 23.06.2000 që rezultojnë në asistencë.
32. Librezë pensioni nr. {***}, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore {***}, në emër të znj. E.B. – data e fillimit 22.07.2005.
33. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale {***} [nr. {***} prot., datë 31.05.2019], sipas së cilit pensioni ka filluar më datë 06.01.2007 dhe të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore për periudhën 06.01.2007 – 30.12.2011 janë 1.017.196 lekë.

²⁷ Sipas vërtetimit për vitet 1983-1986, ky institucion nuk disponon bordero dhe libra page.

²⁸ Sipas vërtetimit, të dhënat për periudhën 1986-1993 janë nxjerrë nga librat e shkollës së mesme të muzikës {***}.

²⁹ Sipas vërtetimit për periudhën 01.01.1994 – 30.06.1999, të dhënat janë nxjerrë nga listëpagesa e subjektit Shkolla Artistike “{***}”.

34. Mandatpagesë, datë 03.05.2005, data e publikuar 27.04.2005, nga Banka Kombëtare Tregtare, Dega {***}, për Kreditorët e {***}, sipas të cilit është kryer pagesë në *cash* në vlerën 173.563,50 lekë, në emër të znj. E.B..
35. Akti i shitblerjes së pasurisë së paluajtshme (shtëpi banimi) nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 29.09.1996, Shkodër, sipas të cilit shitësit [F., E. dhe F.B.] i shesin apartamentin e banimit,³⁰ blerësit [F.K.], me çmimin 2.100.000 lekë.
36. Kërkesë e datës 30.04.2019 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vënien në dispozicion të të dhënave për pagën e z. F.B. në pozicionin e zv/shefit të Policisë Hetimore për periudhën 01.03.1993 – 01.09.1994.
37. Vërtetim i datës 26.07.2000 nga Seksioni i Shërbimeve Publike Shkodër, sipas të cilit F.B. ka shitur banesën dhe ka depozituar paratë në skemat piramidale dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. {***}, datë 07.02.1998, është në listën e personave që kanë humbur shtëpinë nga rënia e skemave piramidale.
38. Kërkesë e datës 14.06.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga vetë subjekti i rivlerësimit, me palë të tretë Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, me objekt “Vërtetimin e faktit juridik të periudhës së punës nga 08.08.1996 – 31.12.1998, si person fizik, Avokat F.B., me kod fiskal {***}, lidhur me të ardhurat e realizuara për këtë periudhë.
39. *E-mail* për dërgimin e pasqyrës nga “{***}” për periudhën e pagesës 21.05.2009 – 19.07.2013 për L.P., e vërtetuar kopja në letër e dokumentit elektronik me nr. {***} rep., datë 17.09.2019, nga notere M.V.V.³¹

13.3. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit i parashtroi Kolegjit një sërë kërkesash procedurale. Më konkretisht:

1. të pranojë dhe të administrojë në cilësinë e provave aktet dhe dokumentet e paraqitura;
2. të dhënat e akteve dhe dokumenteve të paraqitura të bëhen pjesë e analizës financiare të Komisionerit Publik dhe të Kolegjit;
3. analiza financiare të bëhet vetëm për vlerën 25.000 euro dhe 1.800.000 lekë mbi bazën e provave të reja të paraqitura në këtë gjykim, pasi pjesa tjetër financiare është trajtuar nga Komisioni dhe nuk është ankimuar nga Komisioneri Publik, ndërsa vetë Kolegji ka disponuar me vendim të ndërmjetëm mospranimin e riçeljes së hetimit, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni ushqimor;
4. të mos marrë në konsideratë denoncimin dhe interpretimin e pasaktë të të dhënave të depozituara nga B.T. dhe K.Ç.;
5. në seancën e datës 12.04.2019, subjekti i rivlerësimit parashtroi kërkesën që në vijim të procesit të këtë të pranishëm edhe përfaqësuesin ligjor, Avokat L.L, referuar nenit 96 të K.Pr.Civile;
6. në seancën e datës 26.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlerëson që hetimi është i plotë dhe t’i jepej fund për të kaluar në konkluzionet përfundimtare;

³⁰ Regjistruar me nr. pasurie {***}, datë 12.11.1993.

³¹ Ky dokument u është bashkëlidhur parashtrimeve mbi kundërshtimin e analizës ekonomike financiare, datë 17.06.2019, për të përlllogaritur kështet mujore sipas vlerës reale (faqja 13 e materialit).

7. aplikimin e nenit 32, pika 2 dhe 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa i përket ligjshmërisë së të ardhurave të prindërve për dhurimin e 1.800.000 lekëve nga nëna;
8. në referim të nenit 125 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”), të disponohet nga Kolegji për mënyrën si do të procedohet për vlerësimin e provave të administruara në raport me nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një vendim i detyrueshëm për vijimësinë e procesit;
9. marrjen në cilësinë e provës të pohimeve të Komisionerit Publik, të dhëna mbi saktësimin e shkaqeve të ankimit në seancën e datës 05.06.2019, duke ua bashkëlidhur të gjitha provave të paraqitura deri në atë fazë;
10. pezullimin e gjykimit, mbështetur në nenin 297 të K.Pr.Civile, deri në përfundimin e gjykimit të kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {***}, datë 14.06.2019, lidhur me vërtetimin e të ardhurave të F.B. – kërkesë e paraqitur në seancën e datës 17.06.2019 nga subjekti i rivlerësimit;
11. revokimin e vendimit të ndërmjetëm për pasqyrën financiare, për ta formuluar në dy versione (kërkesë e paraqitur në datë 17.06.2019):
 - a) brenda interpretimit të subjektit për kufijtë e ankimit, lidhur me burimin e ligjshëm të 25.000 eurove, të vlerës 1.800.000 lekë dhe të vlerës së rivlerësimit të pasurisë në Durrës, duke përfshirë edhe vendimet e ndërmjetme të Kolegjit të datës 18.12.2018;
 - b) brenda interpretimit të subjektit për kufijtë e ankimit, sipas vendimit të ndërmjetëm të datës 18.12.2018, si dhe duke marrë në konsideratë provat në bazë të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

13.4. Subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesën për përjashtimin e relatores së çështjes pranë Kolegjit, gjyqtares Rezarta Schuetz, me pretendimin e njëanshmërisë dhe paragjykimit në shqyrtimin e çështjes dhe gjendjen e gjyqtares në kushtet e nenit 72, pika 4 e K.Pr.Civile.³² Kërkesën për përjashtimin e gjyqtares relatores, subjekti i rivlerësimit e bazonte në dyshimin e pretenduar të konfirmuar se veprimet e gjyqtares relatores në seancën gjyqësore të datës 17.06.2019 tregonin njëanshmëri të theksuar, me shfaqjen e argumenteve të njëanshme e në mënyrë të papërshtatshme, paragjyquese mbi fakte dhe rrethana objekt gjykimi, pasi:

- a) ka dhënë këshilla dhe mendime për çështjen, të cilat janë bërë të njohura jashtë këtij procesi gjyqësor³³, duke u ndodhur në kushtet e nenit 72, pika 4 e K.Pr.Civile;
- b) vërtetohen sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie me shfaqjen e mendimit të njëanshëm e në mënyrë të papërshtatshme, mbi fakte dhe rrethana objekt gjykimi dhe paragjykimi lidhur me vendimet e ndërmjetme të kësaj gjykate, duke u ndodhur në kushtet e nenit 72, pika 6 e K.Pr.Civile;

³² Kërkesa për përjashtim të një ose disa anëtarëve të trupit gjykues, pa identifikuar cilin, u parashtrua fillimisht në formë verbale në seancën e datës 17.06.2019. Më pas, përjashtimi u kërkuar me shkrim, me nr. {***} prot., datë 20.06.2019 për relatoren e çështjes.

³³ Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, në seancë gjyqësore, iu referua një dokumenti me natyrë konfidenciale që i përket procesit të përgatitjes së relacionit ligjor në zbatim të nenit 23, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 27 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/Rregullore-per-veprimtarine-e-Kolegjit-te-Posacem-te-Apelimit-2.pdf>.”

c) nuk ka vlerësuar me ndërgjegje dhe ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, duke u ndodhur në kushtet e nenit 16, pikat 1, 9, 10 dhe 12 të ligjit nr. 84/2016.

13.5. Gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Komisioneri Publik të shprehej lidhur me:³⁴

1. nëse u qëndronte përfundimisht shkaqeve të ankimit vetëm për çështjet që janë hetuar nga Kolegji (3 çështje);
2. nëse kishte pretendime të tjera lidhur me procesin, duke marrë në konsideratë parashtrimet e tij të datave 13.12.2019, 18.12.2019, si dhe vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit të datës 18.12.2018.

13.6. Qëndrimi i Komisionerit Publik, në përgjigje të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit të datës 05.06.2019 është përmbledhur më sipër, në paragrafin 11 të këtij vendimi.

13.7. Në konkluzionet përfundimtare të datës 02.07.2019, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, parashtroi se:

1. disa elemente të këtij gjykimi përbënin shkelje dhe kanë çuar në një proces jo të rregullt ligjor. Konkretisht, sipas saj, analiza financiare që i është vënë në dispozicion më datë 25.03.2019, del tej vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues të datës 18.12.2018 dhe jashtë ankimit të bërë nga Komisioneri Publik më 14.08.2018, si dhe tej parashtrimeve të datës 13.12.2018 dhe 18.12.2018 dhe pjesërisht saktësimeve të datës 05.06.2019. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo shkelje vijoi në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë procesit. Analiza financiare e datës 22.05.2019 bie ndesh me pasqyrën e parë financiare, gjë që në vlerësimin e saj tregon dukshëm jo vetëm njëanshmëri, por edhe jokorrektësi nga ekspertët e Njësisë së Shërbimit Ligjor;
2. në seancën e datës 17.06.2019 relatorja e çështjes ka shkelur ligjin procedural dhe ka treguar dukshëm njëanshmëri dhe paragjykim, që për subjektin përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, nenit 72, pikat 4 dhe 6 dhe nenit 73 të K.Pr.Civile, nenit 16, pikat 1, 9, 10 dhe 12 të ligjit nr. 84/2016;
3. në referim të nenit 32/2 dhe 52/2 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi Kolegjit të shprehet për nivelin e provueshmërisë së akteve të paraqitura. Vendimi i trupit gjykues që për këto çështje të shprehet me vendim përfundimtar, sipas subjektit, i mohoi mundësinë e paraqitjes së provave të tjera, në referim të nenit 52/2 të këtij ligji;
4. në seancën e datës 17.06.2019, kërkoi revokimin e analizës financiare të hartuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe, meqenëse Kolegji do të shprehej me vendim përfundimtar, nga ana e subjektit u kërkua ribërja e pasqyrës financiare “brenda kufijve të ankimit dhe vendimit të ndërmjetëm të Kolegjit të datës 18.12.2018”³⁵, në dy variante: duke mbajtur në konsideratë provat sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe duke mos i marrë parasysh ato;

³⁴ Kërkesa të parashtruara në seancën e datës 05.06.2019.

³⁵ Sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit në seancën publike të datës 05.06.2019.

5. një kërkesë për pezullimin e gjykimit derisa të vërtetoheshin gjyqësisht fakte dhe prova lidhur me të ardhurat e prindërve, meqenëse ka dokumentacion që është djegur në trazirat e viteve 1997-1998, për shkak të kohës së gjatë, si dhe informacioneve të paplota të dhëna nga institucionet. Kjo kërkesë nuk u pranua nga trupi gjykues, me arsyetimin se procesi i rivlerësimit nuk kushtëzohet nga procesi që kërkon të zhvillojë subjekti, duke mos qenë në kushtet e nenit 297 të K.Pr.Civile³⁶. Sipas subjektit, ky vendim i trupit gjykues ishte në kundërshtim me vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit të datës 17.06.2019, sipas të cilit subjektit të rivlerësimit iu dha mundësia për paraqitjen e provave deri në përfundim të hetimit gjyqësor dhe i krijoi bindjen se procesi ishte i paragjykuar. Më tej, subjekti pretendoi se në këtë mënyrë iu mohua mundësia për të provuar të ardhurat e prindërve në tërësi, ndërkohë që ato pjesërisht janë provuar. Sipas subjektit, në këtë mënyrë i është mohuar një e drejtë, meqenëse Komisioni nuk ka ngritur asnjë pretendim për të ardhurat e prindërve, nuk i kishte kaluar barrën e provës dhe nga Kolegji nuk u bë vlerësimi i provave, në referim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016;
6. Komisioneri Publik nuk ka mbajtur të njëjtin standard – ka vendime të tjera të Komisionit të cilat Komisioneri Publik nuk i ka ankimuar, që kanë pasur të njëjtat situata me këtë proces. Në vlerësimin e subjektit, kjo ka çuar në shkelje të të drejtave të subjektit dhe proces jo të rregullt ligjor.
7. është provuar përpara Kolegjit burimi i ligjshëm i huas prej 25.000 eurosh, të dhënë nga tezja, znj. D.P., dërguar nëpërmjet BKT-së, në shtator 2015, e cila ka shërbyer për blerjen e apartamentit;
8. huaja prej 4.000.000 lekësh H.B. në vitin 2006, dhënë nga nëna e subjektit të rivlerësimit dhe e kthyer në dy pjesë [1.500.000 lekë në vitin 2011 dhe 2.500.000 lekë në vitin 2013] duhet të merret në konsideratë pasi dëshmon kursimet e prindërve, përbën një veprim juridik të konfirmuar me deklaratën noteriale të vitit 2013, është realizuar në vitin 2006 kur subjekti nuk ka qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, ndërsa nëna [e subjektit] jetonte më vete dhe financiarisht ishte veç nga subjekti;
9. është provuar se prindërit kanë pasur mundësi të kenë kursime të cilat janë përdorur nga nëna, E.B., përveçse për huan e mësipërme në vitin 2006, edhe për pagimin e qirasë dhe dhurimin prej 1.800.000 lekësh subjektit, për shlyerjen e detyrimit ndaj tezes në vitin 2016, e konfirmuar me aktin noterial nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.2018;
10. referuar të ardhurave dhe shpenzimeve, deklarimeve ndër vite, si dhe pasurive që rezultojnë në emër të subjektit të rivlerësimit, analiza financiare duhet të bëhet vetëm për vlerat 25.000 euro dhe 1.800.000 lekë, mbi bazën e provave të reja të paraqitura në këtë gjykim, si dhe rivlerësimin e shtëpisë në Durrës. Pjesa tjetër financiare është trajtuar nga Komisioni dhe, sipas subjektit, nuk është ankimuar nga Komisioneri Publik;

³⁶ Neni 297 i K.Pr.C parashikon: “[...] Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative; b) kërkohet nga të dyja palët; c) njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik; ç) njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t’i emërohet një përfaqësues ligjor; d) parashikohet shprehimisht në ligj. Gjatë pezullimit nuk mund të kryhen veprime procedurale.” Shih më poshtë arsyetimin në paragrafin 18, pika “xvi”, me vendimet e tjera të ndërmjetme të trupit gjykues.

11. për sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik të datës 13.12.2008, lidhur me çeljen e hetimit për burimin e ligjshëm të pensionit ushqimor, duke qenë se është përdorur si burim për blerjen e makinës dhe shlyerjen e huas në vlerën 1.700.000 lekë, meqenëse Kolegji me vendim të ndërmjetëm vendosi të mos hetojë për të ardhurat e përfituara nga pensioni ushqimor, Komisioneri Publik në mënyrë abuzive ndryshoi shkaqet e ankimit duke pretenduar në seancën e datës 05.06.2019 që burimi i vlerës 1.700.000 lekë lidhet me mundësitë e kursimit të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, Kolegji nuk duhet të lejojë këto ndryshime dhe të mbajë një qëndrim konstant dhe të drejtë në raport me vendimet e tij të ndërmjetme;
12. subjekti thekson se makina e blerë në vitin 2011 dhe banesa që ka në përdorim që nga viti 2015, pronësia e së cilës fitohet në vitin 2035 (pas shlyerjes së kredisë), janë në funksion të jetesës së fëmijëve dhe të familjes.

13.8. Për sa ka parashtruar, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka provuar tërësisht burimin e ligjshëm të vlerës 25.000 euro, të dhënë hua në vitin 2015, dhe burimin e ligjshëm të vlerës 1.800.000 lekë, dhuratë nga ana e E.B. në vitin 2016, si dhe ka provuar mundësinë e pagesës në shumën 40.439 lekë, për pjesën takuese $\frac{1}{4}$, për rivlerësimin e shtëpisë në Durrës. Për kërkimet e tjera, Komisioneri Publik ka hequr dorë, pretendoi subjekti, duke kërkuar përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

I. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të pezullimeve, shoqëruar nga detyrimi për trajnim.³⁷ Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili pas rivlerësimit e ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Brati, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15

³⁷ Neni F, pika 2 dhe neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, të cilët bashkërisht përcaktojnë që të vetmet vendime të cilat nuk i nënshtrohen ankimit në procesin e rivlerësimit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, janë ato që lidhen me vendime pezulluese dhe trajnim të detyrueshëm për subjektin e rivlerësimit.

ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016³⁸.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit nga Komisioneri Publik kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit nr. 32, datë 05.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Brati, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në datat 13.12.2018, 18.12.2018, 05.02.2019, 11.03.2019, 25.03.2019, 12.04.2019, 26.04.2019, 22.05.2019, 05.06.2019, 17.06.2019 dhe 02.07.2019 në prani të palëve, si dhe të përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, avokatit L.L.³⁹. Në seancën gjyqësore të datës 09.07.2019, gjatë së cilës u shpall vendimi, ishte i pranishëm vetëm përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit.
17. Pasi dëgjoi shpjegimet e palëve lidhur me ankimin, në funksion të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi hapjen e hetimit gjyqësor, marrjen si prova të dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, administrimin e dokumenteve të kërkuara nga institucionet shtetërore, me qëllim saktësimin e informacionit provues në funksion të hetimit, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me:
 - i) verifikimin e burimeve financiare të personave të tjerë të lidhur – D.P., M.P. dhe L.P., përkatësisht, tezza, bashkëshortja dhe djali i tezes së subjektit të rivlerësimit – për dhënien e 25000 eurove hua në vitin 2015 subjektit të rivlerësimit. Sipas subjektit, kjo shumë ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi, me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë;
 - ii) verifikimin e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur, znj. E.B. – nëna e subjektit të rivlerësimit – për dhurimin e shumës prej 1800000 lekësh në vitin 2016, që subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, sipas pohimeve të saj, e ka përdorur për të shlyer një pjesë të huas së marrë personave të tjerë të lidhur [D.P., M.P. dhe L.P.];
 - iii) verifikimin e saktësisë së deklaramentit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar kursimet e deklaruara në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar në vitet 2014 dhe 2015.
18. Trupi gjykues i Kolegjit mori vendimet e ndërmjetme që vijnë, të renditura në mënyrë kronologjike:
 - i) të lejojë marrjen e provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit;⁴⁰

³⁸ *Shih fashikullin 9. Vendimi nr. 32, datë 05.07.2018, i Komisionit për rivlerësimin e subjektit, znj. Alma Brati, i është njoftuar Institutit të Komisionerit Publik me shkresën nr. {***}, datë 30.07.2018, protokolluar pranë këtij institucioni me nr. {***} prot., datë 30.07.2018. Ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 14.08.2018, protokolluar pranë Komisionit me nr. {***}, datë 14.08.2018.*

³⁹ *Njoftuar pjesëmarrja e tij prej seancës gjyqësore të datës 12.04.2019.*

⁴⁰ *Vendimi i dhënë në seancat gjyqësore të datave 18.12.2018, 11.03.2019, 12.04.2019, 26.04.2019 dhe 05.06.2019.*

- ii) të administrojë provat dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për personat e tjerë të lidhur, L.P. dhe M.P.;⁴¹
- iii) të kërkojë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës saktësimin e informacionit që dëshmon pagesën e tatimeve të babait të subjektit të rivlerësimit, z. F.B., për periudhën 1999-2003;⁴²
- iv) të kërkojë nga zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës praktikën e plotë për rivlerësimin dhe regjistrimin e pasurisë në Durrës të subjektit të rivlerësimit;⁴³
- v) të mos hetojë për të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga pensioni ushqimor prej z. K.B.;⁴⁴
- vi) të mos pranojë kërkesën e Komisionerit Publik të kalimit të barrës së provës subjektit të rivlerësimit në momentin procedural që i përkiste seancës publike të datës 05.02.2019;⁴⁵
- vii) t'i njohë subjektit të rivlerësimit të drejtën për të paraqitur akte që vërtetojnë pagimin e tatimeve në Itali nga personat e tjerë të lidhur, M.P. dhe L.P.;⁴⁶
- viii) të mos çelë hetimin për denoncimet e depozituara në Kolegj nga S.I., M.B. dhe B.R. ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi rrethanat e parashtruara nuk përbëjnë prova në lidhje me kriteret e vlerësimit, sipas nenit 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016;⁴⁷
- ix) të njohë subjektin e rivlerësimit me rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj, si rrjedhojë e provave të paraqitura nga subjekti dhe të provave të tjera të marra nga Kolegji;⁴⁸
- x) të mos marrë në cilësinë e provës dhe të kthejë kartelën shoqëruese për praktikën e ndjekur pranë Drejtorisë së Policisë, të konsideruar si të panevojshme, referuar parashikimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016;⁴⁹
- xi) të mos çelë hetim gjyqësor lidhur me denoncimin e depozituar nga B.T dhe K.Ç., në bazë të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016;⁵⁰
- xii) të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provës të pohimit gjyqësor të Komisionerit Publik, duke konstatuar mungesën e kushteve të parashikuara nga neni 283 i K.Pr.Civile dhe duke vlerësuar faktin që subjekti mori përgjigje shteruese nga Komisioneri Publik për pyetjen e parashtruar;⁵¹
- xiii) të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për sa i përkiste mënyrës dhe momentit procedural të vlerësimit të provave të paraqitura prej tij, bazuar në nenet 4, pika 6, 52, pika 2 dhe 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 dhe neni 171/b të K.Pr.Civile pasi vlerësimi individual i nivelit të provueshmërisë së gjithë akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit do të shprehet në vendimin përfundimtar;

⁴¹ Vendimi i dhënë në seancat gjyqësore të datave 18.12.2018 dhe 11.03.2019.

⁴² Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 18.12.2018.

⁴³ Ibid.

⁴⁴ Ibid.

⁴⁵ Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 05.02.2019.

⁴⁶ Ibid.

⁴⁷ Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 11.03.2019.

⁴⁸ Vendimi i dhënë në seancat gjyqësore të datave 25.03.2019 dhe 22.05.2019.

⁴⁹ Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 12.04.2019.

⁵⁰ Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 26.04.2019.

⁵¹ Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 05.06.2019.

- xiv) të mos pranojë kërkesën e subjektit për revokimin e vendimit të ndërmjetëm për analizën financiare, pasi nga ana e Kolegjit nuk ishte dhënë një vendim në kuptimin formal për miratimin e analizës financiare;⁵²
- xv) të shprehet në vendimin përfundimtar mbi vlerësimin e analizës financiare të subjektit të rivlerësimit pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve, prapësimeve dhe provave të paraqitura gjatë procesit;⁵³
- xvi) të refuzojë kërkesën për pezullimin e gjykimit, pasi nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara nga neni 297, germa “a” e K.Pr.Civile, duke qenë se zgjidhja e çështjes nuk varet nga zgjidhja që do të ketë çështja civile për vërtetimin e faktit juridik të periudhës së punës për vitet 1996-1998 të babait të subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, trupi gjykues vuri re që për çështjen në fjalë është investuar Kolegji në këtë proces, në përgjigje të pretendimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti në lidhje me këtë fakt.⁵⁴
- xvii) Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegji, trupi gjykues me qëllim miradministrimin e gjykimit dhe zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor u shpreh me vendime procedurale, të cilat në çdo seancë iu komunikuan edhe palëve⁵⁵.

19. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues nga shqyrtimi i çështjes, të parashtruar fillimisht verbalisht në seancën e datës 17.06.2019, trupi gjykues i Kolegjit, në përputhje me përcaktimet e nenit 75, paragrafi i fundit i K.Pr.Civile, arsyetoi se kërkesa do të shqyrtohet nga një tjetër trup gjykues dhe gjykimi nuk pezullohet. Dispozita në fjalë kërkon që gjyqtari për të cilin kërkohet përjashtimi nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit. Në përgjigje të kërkesës me shkrim të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit [nr. {***} prot.] datë 20.06.2019, për përjashtimin e gjyqtarës relatores, bazuar në nenin 75 të K.Pr.Civile, duke mbajtur në konsideratë zbatimin e parimit të paanësisë në gjykim, Kolegji garantoj shqyrtimin e kërkesës me një trup gjykues, në të cilin gjyqtarja relatores e çështjes nuk ishte anëtare. Me vendimin nr. {***}, datë 02.07.2019, trupi gjykues i zgjedhur me shortin e datës 20.06.2019 për shqyrtimin e kësaj kërkesë të subjektit të rivlerësimit vendosi rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e relatores. Ky trup gjykues, i shortuar më datë 20.06.2019, konstatoi se qëndrimet e mbajtura nga gjyqtarja relatores gjatë gjykimit në seancë gjyqësore publike janë qëndrime të cilat ajo i ka kryer në funksion të përmbushjes së funksionit të saj procedural si

⁵² Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 17.06.2019.

⁵³ Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 17.06.2019.

⁵⁴ Vendimi i dhënë në seancën gjyqësore të datës 17.06.2019.

⁵⁵ Në seancën gjyqësore të datës 18.12.2018, trupi gjykues vendosi t'u drejtohet autoriteteve tatimore italiane, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me përmbushjen e detyrimeve tatimore nga personat e tjerë të lidhur, L. dhe M.P. Në mungesë të përgjigjes nga autoritetet italiane, për efekt të ekonomisë gjyqësore, në seancën e datës 05.02.2019 iu kërkua subjektit të rivlerësimit të paraqiste këto dokumente. Në këtë seancë, trupi gjykues vendosi të mos pranojë kërkesën e Komisionerit Publik për revokimin e vendimit për marrjen e provës nga autoritetet tatimore italiane. Në seancën e datës 11.03.2019, subjekti paraqiti dokumentacionin e kërkuar dhe trupi gjykues vendosi revokimin e vendimit të dhënë në seancën e datës 18.12.2018; në seancën gjyqësore të datës 11.03.2019, trupi gjykues vendosi të mos pranojë kërkesën e Komisionerit Publik për revokimin e vendimit për marrjen e provës nga autoritetet tatimore italiane; në seancën e datës 12.04.2019, trupi gjykues vendosi t'i japë subjektit të rivlerësimit një kopje të denoncimit të depozituar nga denoncuesit B.T. dhe K.Ç. dhe të caktojë një përkthyes nga lista e përkthyesve të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për përkthimin e akteve të ardhura bashkëlidhur këtyre denoncimeve.

relatore e trupit gjykues, dhe në asnjë nga rrethanat e pretenduara ato nuk rezultojnë të përbëjnë shkaqe që tregojnë njëanshmëri, shprehje dhe qëndrime të papërshtatshme apo paragjykim të zgjidhjes së çështjes nga ana e saj. Trupi gjykues vlerësoi se gjyqtarja relatore ka ushtruar funksionet e saj me paanshmëri të plotë, duke garantuar në këtë mënyrë dukjen e paanshmërisë.

20. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor të trajtuar në pikën 13.7 të këtij vendimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se procesi gjyqësor në Kolegjin është kryer mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit. Procesi gjyqësor konkret i ofroi dhe i mundësoi subjektit të rivlerësimit të gjitha garancitë për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 42 dhe 179/b të Kushtetutës, të shtjelluara edhe në vendimin nr. {***} të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias. Kështu, subjekti i rivlerësimit ka gëzuar plotësisht garancitë procedurale të procesit të rregullt ligjor, lidhur ndër të tjera edhe me:
- a) njohjen me ankimin e datës 14.08.2018, të Komisionerit Publik, të paraqitur rregullisht në funksion edhe të parashtresave të paraqitura prej tij gjatë seancave publike në Kolegjin;
 - b) mundësinë për të dhënë shpjegime me shkrim dhe me gojë gjatë procesit të hetimit gjyqësor;
 - c) kohën e nevojshme për të paraqitur prova dhe dokumente, për të përgatitur kundërgargumentet dhe prapësimet e nevojshme gjatë gjithë procesit të zhvilluar në Kolegjin;
 - ç) njohjen në çdo kohë me dokumentacionin e administruar nga Kolegji. Trupi gjykues vëren edhe që subjekti i rivlerësimit nuk kundërshtoi kohën e vënë në dispozicion nga Kolegji, njohjen me dokumentacionin⁵⁶ apo mundësinë për të parashtruar argumentet e saj në asnjë parashtrim⁵⁷.

⁵⁶ Shih korrespondencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit:

i) shkresa nr. {***} prot., datë 03.04.2019, me lëndë “Kthim përgjigjeje”, nëpërmjet së cilës, subjektit të rivlerësimit i janë vënë në dispozicion fotokopje të procesverbale të seancave gjyqësore publike, si dhe CD me materialet audio të këtyre seancave (në përgjigje të kërkesës me shkrim, me lëndë “Vënie në dispozicion të kopjeve të procesverbaleve të seancave të zhvilluara pranë KPA, si dhe të regjistrimeve “audio”, administruar dhe regjistruar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 01.04.2019);

ii) shkresa nr. {***} prot., datë 19.06.2019, me lëndë “Kthim përgjigjeje”, nëpërmjet së cilës subjektit të rivlerësimit i është në dispozicion kopje e regjistrimeve audio të seancës gjyqësore publike, të zhvilluar më datë 17.06.2019, si dhe një CD me materiale audio të kësaj seance (në përgjigje të kërkesës me shkrim datë 18.06.2019, me lëndë “Vënie në dispozicion e kopjeve të regjistrimeve “audio” të seancës së zhvilluar pranë KPA më datë 17.06.2019, të administruar dhe regjistruar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 18.06.2019);

iii) shkresa nr. {***} prot., datë 21.06.2019, me lëndë “Kthim përgjigjeje”, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit është njoftuar se mund të paraqitet pranë ambienteve të Kolegjit për të studiuar dosjen e çështjes, duke shprehur gatishmërinë për t’i vënë në dispozicion dosjen dhe kopjen e akteve të kërkuara, më datë 24.06.2019, ora 14⁰⁰ - 16⁰⁰ (në përgjigje të kërkesave me shkrim nr. {***} prot., datë 18.06.2019, me lëndë “Studim i dosjes gjyqësore të ndodhur në KPA”; nr. {***} prot., datë 18.06.2019, me lëndë “Kopje e faqes së protokollit të dt. 14.08.2018” dhe nr. {***} prot., datë 18.06.2019, me lëndë “Kopje e procesverbaleve të dt. 12.04.2019, dt. 26.04.2019, dt. 22.05.2019, dt. 05.06.2019”, të administruara dhe regjistruara pranë Kolegjit me nr. {***}, datë 20.06.2019). Marrja e njoftimit është konfirmuar nga subjekti i rivlerësimit në rrugë elektronike më datë 21.06.2019 (në të njëjtën ditë), ora 14:54. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit më datë 24.06.2019, duke mos dhënë njoftim dhe arsye.

⁵⁷Aktet me shkrim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit drejtuar Kolegjit, nëpërmjet të cilave ka parashtruar argumentet e saj (përveç akteve dhe dokumenteve të paraqitura dhe të pranuara në cilësinë e provës, të cituara në pikën 13.2 të këtij vendimi) janë:

- i) prapësimet me shkrim, të regjistruara pranë Kolegjit me nr. {***}, datë 11.12.2018;
- ii) parashtrimet me shkrim të paraqitura në seancën e datës 12.04.2019;
- iii) parashtrimet me shkrim të paraqitura në seancën e datës 26.04.2019;

21. Bazuar në provat e mara gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit mbi verifikimin e saktësisë së deklarimit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të justifikuar kursimet e deklaruara në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues vendosi të kryejë analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për periudhën e rivlerësimit 2007-2016. Analiza financiare iu dha njëkohësisht subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, bashkë me kohën dhe mundësinë për ta debatuar në seancat gjyqësore publike. Në funksion të kësaj analize financiare, subjekti i rivlerësimit kërkoi marrjen e provave të tjera shkresore. Këto të fundit, pasi u pranuan nga trupi gjykues, u debatuan prej palëve.
22. Aktet e përcjella nga institucionet kompetente shtetërore, lidhur me hetimet e zhvilluara si më sipër, si dhe aktet shkresore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me kundërshtimet ndaj ankimit dhe ato në seancat në vijim, u morën në cilësinë e provave nga trupi gjykues i Kolegjit dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor lidhur me vlerën provuese të tyre.

II. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit

*i) Burimi i ligjshëm i huas prej 25000 eurosh në vitin 2015, burim krijimi i pasurisë apartament banimi, me adresë rr. “{***}”, Tiranë dhe burimi i ligjshëm i shumës prej 1800.000 lekësh, në vitin 2016, dhuruar për të shlyer një pjesë të huas të marrë në vitin 2015.*

23. Komisioneri Publik kërkoi hetimin dhe administrimin e provave mbi burimin dhe ligjshmërinë e të dyja shumave, huas në shumën 25.000 euro dhe dhurimit të shumës 1.800.000 lekë. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, D.P. (huadhënësja) dhe E.B. (dhuruesja) kanë pasur lidhje interesi që rrjedh nga një interes pasuror me subjektin e rivlerësimit dhe, për pasojë, të dy këta persona duhet të marrin cilësinë e personit tjetër të lidhur, duke u kaluar detyrimin për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave, dhënë hua dhe dhuruar subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit vëren sa vijon:

*iv) kërkesë me shkrim nr. {***} prot., datë 05.06.2019, me lëndë “Paraqitje e provave të reja”;*

*v) kërkesë me shkrim nr. {***} prot., datë 05.06.2019, me lëndë “Pyejtje drejtuar Komisionerit Publik”;*

*vi) kërkesë me shkrim nr. {***} prot., datë 05.06.2019, me lëndë “Të aplikohet neni 32/2 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sa i përket ligjshmërisë së të ardhurave të prindërve për dhuratën 1.800.000 lekë nga nëna ime”;*

vii) kërkesë me shkrim datë 17.06.2019, me lëndë “Pezullimin e gjykimit”;

*viii) kërkesë me shkrim nr. {***} prot., datë 17.06.2019, me lëndë “Revokimin e vendimit të ndërmjetëm të marrë nga KPA për pasqyrën financiare”;*

*ix) parashtrime me shkrim nr. {***}, datë 17.06.2019, me lëndë “Kundërshtim i analizës financiare dt. 22.05.2019 nga KPA”;*

*x) kërkesë me shkrim nr. {***} prot., datë 20.06.2019, me lëndë “Përrjashtim i relatores së çështjes pranë Kolegjit të Apelit, znj. Rezarta Schuetz”;*

*xi) konkluzionet përfundimtare me shkrim nr. {***} prot., datë 01.07.2019.*

a) *Mbi burimin e ligjshëm të shumës 25.000 euro, të marrë në formë huaje në vitin 2015*

23.1. Nga hetimi i kryer në Komision në lidhje me aftësinë e znj. D.P. për të dhënë hua shumë 25.000 euro, rezultoi se ajo ka pasur ose ka në llogari bankare shuma të ndryshme në lekë dhe në euro. Po ashtu, llogaritë në BKT në emër të znj. D.P. dhe M.P. provuan se në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është kaluar shuma 25.000 euro në dy këste, përkatësisht 15.000 euro më datë 4.09.2015 dhe 10.000 euro më datë 16.09.2015. Nga analiza e provave, Komisioni çmoi se D.P. i kishte mundësitë financiare për dhënien e kësaj huaje.

23.2. Komisioneri Publik çmon se në zbatim të nenit 32, pikat 4 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.02.2018, konfirmohet marrëdhënia e huas, personit tjetër të lidhur, znj. D.P., duhet t'i kalonte detyrimi për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave, dhënë hua subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin e Komisionerit, standardi kushtetues e ligjor që dispozitat e sipërcituara përcaktojnë mbi kontrollin e pasurisë dhe detyrimi për justifikimin në mënyrë bindëse të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë nga ana e subjektit, nuk pajtohet me përfundimet e arritura nga ana e Komisionit. Ky i fundit, thekson Komisioneri Publik, duket se është bazuar në faktin se huadhënësja ka pasur gjendje në llogarinë bankare për të konstatuar aftësi financiare për t'i siguruar subjektit të rivlerësimit shumat përkatëse. Më tej, Komisioneri Publik sjell në vëmendje se “[...] Pasja e një llogarie bankare nuk ligjëron dhe justifikon burimin e saj. Subjekti i rivlerësimit dhe D.P., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, kanë pasur detyrimin ligjor për të provuar dhe justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave që subjekti i ka përdorur për krijimin e pasurisë. [...]”

23.3. Trupi gjykues, duke pasur parasysh që përveç detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për vetë subjektet e rivlerësimit për të deklaruar saktë dhe bindshëm pasuritë në pronësi apo përdorim dhe burimet e krijimit, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës⁵⁸ dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016⁵⁹, procesi i kontrollit të ligjshmërisë së burimeve dhe të ardhurave në funksion të rivlerësimit kalimtar parasheh si pjesë të pandarë edhe detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Ky detyrim i parashikuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, në paragrafët 1 dhe 4, në vlerësimin e rrethanave faktike të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, shtrihet mbi të ardhurat e të afërmeve të subjektit që kanë dhënë huan [dhe dhurimin]. Të dyja këto marrëdhënie plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji për t'u cilësuar marrëdhënie me interes pasuror me subjektin e rivlerësimit, siç përcaktojnë pika 14 e nenit 3 dhe pika 4 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016:

⁵⁸ *Neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. [...] 3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj. [...]”.*

⁵⁹ *Neni 30 parashikon: “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.”*

Neni 3, pika 14 parashikon: “[...] “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. [...]”

Neni 32, pika 4: “[...] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]”

23.4. Trupi gjykues çmoi se deklarata noteriale e znj. D.P. [me nr. {***} rep., nr. {***} kol.], datë 26.02.2018, në të cilën ajo konfirmonte kthimin e huas nga subjekti i rivlerësimit, përbën konfirmim të marrëdhënies në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në atë deklaratë, ajo pohon: [...] *Unë e quajtura D.P., deklaroj se ia kam dhënë hua shumë 25.000 euro mbesës sime Alma Brati, të cilën e kemi formalizuar me [...]. Unë si bashkëdepozituese kam të drejtën të kryej veprime mbi këto llogari, depozita të cilat i kam bashkë me nusen, M.P.. [...].*

Këtë marrëdhënie e konfirmoi edhe vetë subjekti në pohimet e saj gjatë procesit, si dhe në deklaratën noteriale nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 20.02.2016, ku shkruhet: [...] *Unë e quajtura Alma Brati deklaroj se i detyrohem tezes sime D.P., shumë prej 25.000 euro, shumë e marrë nëpërmjet transfertës bankare [...], vlerë të cilën e kam marrë për blerjen e një apartamenti banimi në [...].*

23.5. Trupi gjykues vlerësoi se në kushtet e shtjelluara më sipër, marrëdhënia pasurore në kuptim të ligjit është konfirmuar. Dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ konfirmon këto transaksione, të pohuara nga subjekti. Më konkretisht, nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se llogaria nga e cila janë transferuar dy këstet e huas është në emër të D. dhe M.P. Kjo e fundit dhe bashkëshorti, L.P., jetojnë në Itali. Nga pohimet në seancë dhe dokumentacioni i administruar nga trupi gjykues si provë, rezultoi që bashkëshortët P. kanë të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e shumë prej 25.000 eurosh. Si rrjedhojë, trupi gjykues i kërkoi subjektit të rivlerësimit që për ekonomi gjyqësore të paraqesë dokumentacionin e kërkuar nga autoritetet italiane për të provuar dhe justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj të ardhure, të dhënë në formën e huas. Në aspektin procedural, barra e provueshmërisë u realizua me administrimin e dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit gjyqësor të zhvilluar nga Kolegji.

23.6. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi administroi dhe vlerësoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur gjatë procesit të hetimit, konkretisht aktet shkresore të sjella nga subjekti i rivlerësimit, të renditura në paragrafin 13.2 (pikat 1-7 të këtij vendimi), krijoi bindjen se personat e tjerë të lidhur, D.P., M.P. dhe L.P., kanë pasur mundësi financiare për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumë 25.000 euro. Të ardhurat e dokumentuara nga subjekti në formën e duhur ligjore, provojnë se huaja rrjedh nga burime të ligjshme, të vërtetuara nga dokumentacioni i lëshuar nga autoritetet italiane, lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e M. dhe L.P.

23.7. Më konkretisht, duke konsideruar me rëndësi për procesin e rivlerësimit të konfirmojë aftësinë financiare të personave të tjerë të lidhur, pavarësisht nga vendndodhja e tyre. Në rastin konkret, për sa i përket M. dhe L.P., të ardhurat e të cilëve përbëjnë burimin e financimit të huas dhënë subjektit të rivlerësimit në vitin 2015, trupi gjykues, bazuar në provat shkresore që u referohen të ardhurave të tyre në Itali për vitet 2000-2015 – ky i fundit viti i huadhënies – duke zbritur kostot e jetesës, përlllogaritur nga Instat Itali, shkresat e autoriteteve tatimore italiane,⁶⁰ shpenzime kredie sipas pohimeve të subjektit në seancat publike të datave 26.04.2019, 17.06.2019 dhe 02.07.2019, në konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se këta dy persona kanë pasur mundësi financiare për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit huan, në shumën prej 25000 eurosh.

23.8. Për shkak të mungesës së përgjigjes nga autoritet italiane⁶¹, lindi nevoja që vetë subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e trupit gjykues, të siguronte gjithë provat e mundshme që konfirmonin aftësinë paguese/financiare të personave të tjerë të lidhur. Në balancë të qëllimit dhe parimeve që drejtojnë procesin e rivlerësimit, përfshirë barrën e provës, barazinë para ligjit, të drejtën për një proces të rregullt dhe interesin publik⁶², trupi gjykues çmon se në rastin konkret, analiza e mundësive huadhënëse të *personave të tjerë të lidhur* të subjektit të rivlerësimit me të ardhura të ligjshme u provua në nivel të mjaftueshëm. Ky vlerësim bëhet edhe parë në kontekstin e dokumentacionit të administruar, si dhe të fakteve e pohimeve të subjektit për marrjen dhe shlyerjen e huas, nga njëra anë, dhe analizës e aftësisë së tij financiare për ta shlyer këtë hua me burime të ligjshme (shih paragrafin 26) nga ana tjetër.

b) Mbi verifikimin e burimit të ligjshëm të shumës 1.800.000 lekë, të marrë në formë dhurate në vitin 2016

23.9. Siç është shtjelluar më sipër në paragrafin 23.3, trupi gjykues u bazua në të njëjtën dispozitë [neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016] për të vlerësuar dhe për të konfirmuar marrëdhënien pasurore mes subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, dhe nënës së saj, lidhur me dhurimin e shumës prej 1.800.000 lekësh. Deklarata noteriale e lëshuar nga znj. E.B. dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit u çmuan nga trupi gjykues si konfirmim i marrëdhënies në dritën e dispozitës më sipër. Me deklaratën noteriale nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 19.04.2018, në të cilën citohet se: [...] *Unë e quajtura E.B. deklaroj se i kam dhuruar vajzës sime, Alma Brati, shumën 1.800.000 lekë, për të shlyer detyrimin që kishte ndaj motrës sime, D.P., për blerjen e apartamentit. [...].*

23.10. Në lidhje me mundësitë financiare të nënës së subjektit të rivlerësimit për t'i dhuruar vlerën 1.800.000 lekë, pas hetimit administrativ, Komisioni ka argumentuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursime në shumën 1.800.000

⁶⁰ Shih poshtëshënimin më sipër, në paragrafin 13.2, lidhur me shkresat nga {***} {***}-{***}-{***}, paraqitur nga subjekti dhe pranuar nga trupi gjykues si prova.

⁶¹ Gjatë gjithë kohëzgjatjes (7) shtatëmuajore të procesit, trupi gjykues nuk mori asnjë përgjigje nga autoritetet italiane.

⁶² Neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, neni 179/b i Kushtetutës, ndër të tjera.

lekë. Ky konstatim i Komisionit u bazua në të dhënat e administruara nga bankat dhe organet tatimore, nga ku rezulton se në vitin 2006, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, nuk ka qenë gjyqtare, nëna e saj kishte të ardhura në banka në shumën 12.000 euro, vlerë e përafërt me shumën e dhuruar nga ana e saj subjektit të rivlerësimit. Në përfundim, Komisioni çmoi se shuma prej 1.800.000 lekësh, e përfituar nga subjekti, duhet të konsiderohet si e ardhur me burime të ligjshme.

23.11. Komisioneri Publik, thekson detyrimin që kishte Komisioni për të vërtetuar burimin e ligjshëm edhe për dhuratën prej 1.800.000 lekësh, duke ngritur të njëjtat argumente si në rastin e *personave të tjerë të lidhur* huadhënës.. Sipas Komisionerit Publik, standardi kushtetues e ligjor që përcaktojnë dispozitat e posaçme mbi kontrollin e pasurisë dhe detyrimi për justifikimin në mënyrë bindëse të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë nga ana e subjektit, nuk pajtohet me përfundimet e arritura nga ana e Komisionit se dhuruesja ka pasur aftësi financiare për t'i siguruar subjektit të rivlerësimit shumat përkatëse, bazuar thjesht në pasjen e një llogarie bankare. Ekzistenca e kësaj të fundit nuk ligjëron dhe justifikon burimin e saj. Subjekti i rivlerësimit dhe znj. E.B., në cilësinë e personit tjetër të lidhur me të, kanë pasur detyrimin ligjor për të provuar dhe justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave që subjekti i ka përdorur për krijimin e pasurisë.

23.12. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të legjislacionit të posaçëm për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve – si edhe në rastin e huas së trajtuar në paragrafin 23.3 – vlerësoi se në kushtet që E.B. ishte deklaruar në cilësinë e dhurueses, lind detyrimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, dhe nënës së saj për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë nga e cila pretendohet të ketë buruar shuma e dhuruar.

23.13. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit mbi të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet e prindërve të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara dhe të provuara me dokumentacion dhe akte shkresore zyrtare, konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të vërtetojë bindshëm burimin e ligjshëm të këtij dhurimi, në kushtet kur aftësia dhuruese e personit tjetër të lidhur është e kufizuar. Konkretisht, raporti i shpenzimeve dhe kursimeve të *personit tjetër të lidhur* E.B. deri në vitin 2016 rezulton të jetë në vlerën 555.637 lekë, ndërsa dhurimi i pretenduar është në vlerën 1,8 milionë lekë. Shih paragrafin 26 të vendimit.

23.14. Në përfundimin e mësipërm, trupi gjykues arriti pasi mori në konsideratë dhe analizoi për këtë qëllim të gjitha shkresat e sjella nga subjekti i rivlerësimit që u përkasin të ardhurave të nënës dhe babait – konkretisht provat e renditura në paragrafin 13.2, pikat 10-17 dhe pikat 19-25 të këtij vendimi për të ardhurat nga puna e z. F.B., si dhe pikat 26-33 për të ardhurat e përfituara nga pagat dhe pensionet e znj. E.B. Nga ana tjetër, pasi vlerësoi me kujdes pretendimet e subjektit se prindërit e tij kanë pasur të ardhura të konsiderueshme për pasojë të shumë viteve punë, përfshirë aktivitetin privat të të atit, por edhe punësimet e tij të mëparshme, trupi gjykues vëren se ky pretendim duhet analizuar në pjesë të ndara kohore kundrejt dokumentacionit që dëshmon ligjshmërinë e të ardhurave dhe fakteve të pohuara gjatë procesit. Konkretisht,

përkundër pretendimit të subjektit dhe arsyesimit të kryer në Komision, trupi gjykues vëren se të ardhurat e përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi atë vit për shkak të ndryshimeve të natyrës politike, janë të papërfillshme⁶³ për shkak të inflacionit deri në 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare⁶⁴. Si rrjedhojë, shkresat e sjella⁶⁵ nga subjekti i rivlerësimit për të vërtetuar kursime të konsiderueshme, përbëjnë prova të cilat ndonëse të rregullta dhe të besueshme, kërkojnë të provojnë një pretendim i cili bie ndesh me fakte të njohura botërisht dhe informacionin zyrtar. Për pasojë, këto shkresa u çmuan me vlerë provuese të kufizuar në kontekstin e rivlerësimit dhe pa efekt në vendimmarrjen e trupit gjykues⁶⁶.

23.15. Së dyti, trupi gjykues vëren se ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, dokumentet në fashikull, dokumentet e paraqitura prej tij⁶⁷ dhe vetë pohimi i tij gjyqësor⁶⁸ konfirmuan se prindërit e subjektit humbën të ardhurat nga shitja e apartamentit në skemat piramidale, të cilat funksionuan në Shqipëri dhe shkaktuan krizën, përfshirë atë financiare, të vitit 1997. Si rrjedhojë, përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në të njëjtën linjë si shpjegimet e trajtuara më sipër në paragrafin 23.14, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit nuk mund të pranohet, pasi bie ndesh me provat, përfshirë edhe vërtetimin nga Seksioni i Shërbimeve Publike Shkodër, që të ardhurat nga shitja e banesës kanë humbur në firmat piramidale⁶⁹. Për këtë arsye, edhe aktet e sjella për të provuar vazhdimësinë e kursimeve të konsiderueshme nga prindërit për periudhën kohore 1992-1997⁷⁰, u çmuan me vlerë të kufizuar provuese dhe pa efekt në vendimmarrjen e trupit gjykues.

Po ashtu, pretendimi i subjektit për të ardhura nga punësimi i pandërprerë i të atit si avokat në periudhën 1996-1999 në Shkodër, nuk provon burimin e ligjshëm të të ardhurave. Meqenëse analiza e aftësinë financiare të nënës së subjektit të rivlerësimit për t'i dhuruar subjektit të rivlerësimit 1,8 milionë lekë në vitin 2016 është referuar e lidhur me të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti i të atit të subjektit si avokat nga viti 1996 deri në vitin 2003 (kur rezulton të ketë kaluar në status pasiv), trupi gjykues mori në konsideratë një sërë dokumentesh zyrtare, përfshirë

⁶³ <https://data.worldbank.org/indicator/FP.CPI.TOTL.ZG?locations=AL>
<https://www.ebrd.com/downloads/research/economics/workingpapers/wp0088.pdf>
[https://www.indexmundi.com/albania/inflation_rate_\(consumer_prices\).html](https://www.indexmundi.com/albania/inflation_rate_(consumer_prices).html)
<http://open.data.al/en/lajme/lajm/id/71/Historic-Inflation-in-Albania>
https://www.bankofalbania.org/rc/doc/inflacioni_8660.pdf_faqe_18_dhe_19
<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/71/titull/HistorikiInflacionitneShqiperi/Historik-i-Inflacionit-ne-Shqiperi>

⁶⁴ Shih më sipër.

⁶⁵ Aktet e renditura në paragrafin 13.2, pikat 10-13 dhe 26, 27, 28 dhe (6) gjashtë pikat e para të 29.

⁶⁶ Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelit të bazojnë vendimin e tyre vetëm [...] në prova që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. [...]”.

⁶⁷ Shih paragrafin 13.2, pikat 35 dhe 37, akte të sjella nga subjekti i rivlerësimit.

⁶⁸ Në procesverbalin e seancës publike të datës 12.04.2019, subjekti u shpreh: “[...] Po, të shtëpisë po. [...] dhe komplet vlerën e shtëpisë që e kanë shitur, 20-tëshen apo 23 sa ka qenë shitur shtëpia atëherë, e kanë futur atje [...]”. Shih edhe procesverbalin e pyetjes së K.B. në KPK, datë 25.04.2018, administruar në fashikullin nr. 4, faqe 445, sipas të cilit prindërit e subjektit erdhën të jetonin me këtë të fundit dhe ish-bashkëshortin pasi humbën burimet financiare në skemat piramidale.

⁶⁹ Shih më sipër, paragrafi 13.2, pika 37 – akt i sjellë nga subjekti i rivlerësimit.

⁷⁰ Paragrafi 13.2, shkresat e renditura në pikat 10-13, pikën 29 për vitet 1993-1997 për E.B. dhe pjesërisht shkresa e cituar në pikën 31.

ato të sjella nga subjekti dhe shkresat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe i pasqyroj në analizën financiare. Në analizë të të gjitha këtyre dokumenteve, trupi gjykues vlerësoi se subjekti nuk arriti të vërtetonte aftësinë e nënës së saj për të disponuar me burime të ligjshme shumë të pretenduar të dhuruar. Shih paragrafin 26 më poshtë.

23.16. Ndër to, të dhënat nga Drejtoria Rajonale Tatimore {***}⁷¹, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore/Drejtoria Rajonale {***}⁷² dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit⁷³ dokumentuan burime të ligjshme të ardhurash nga avokatia, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës vetëm për një periudhë katër (4) mujore, konkretisht gusht – dhjetor 1996, në Shkodër. Në kontekst të këtyre dispozitave detyruese, vendimet gjyqësore⁷⁴ të sjella nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të ardhura nga avokatia, të cilat më pas janë përdorur për dhurimin ndaj saj në vitin 2016, nuk kanë vlerë provuese për ligjshmërinë e burimeve. Duke aplikuar kërkesat e të njëjtave dispozita kushtetuese dhe ligjore edhe për periudhën kohore 1999-2003, gjatë së cilës z. B. ka punuar avokat në Durrës, lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave, trupi gjykues u mbështet në shkresën zyrtare nga Drejtoria Rajonale Tatimore {***}⁷⁵, e cila vërtetonte të ardhurat e ligjshme për z. B. për periudhën kohore 1999-2002. (Shih përlllogaritjen financiare në paragrafin 26). Me të njëjtën logjikë, vendimet e sjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {***}, u vlerësuan vetëm të kryqëzuara me periudhën kohore për të cilën dokumentacioni zyrtar provon ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, në rastin konkret 16.09.1999 – 30.09.2003⁷⁶. Në të njëjtin kontekst, u analizua edhe vërtetimi nga Spitali Rajonal {***}, lidhur me trajtimin e z. F.S.B. në atë institucion nga 30.12.2003 deri më datë 19.01.2004⁷⁷, dhe megjithëse një dokument zyrtar i rregullt, parë në kontekstin e kryqëzimit me informacionin nga organet tatimore {***} për burimin e ligjshëm të

⁷¹ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 28.03.2018, administruar në fashikullin nr. 2, faqe 175.

⁷² Shih shkresën nr. {***} prot., datë 27.03.2018, administruar në fashikullin nr. 2, faqe 176.

⁷³ Shih vërtetimi nr. {***} prot., datë 09.10.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor, Dega Tatime e Taksa e Rrethit {***}, nr. serial {***}, me kod fiskal {***} dhe mandatarkëtimin nr. {***}, datë 05.08.1996, në vlerën 5.000 lekë, për çelje llogarie nga F.B., nr. llogarie {***}, Shkodër – shih paragrafin 13.2. të këtij vendimi.

⁷⁴ Shih paragrafin 13.2, pika 17, shkresë nr. {***} prot., datë 05.12.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor {***}.

⁷⁵ Shih shkresa nr. {***} prot., datë 28.12.2018, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve {***}, me lëndë “Saktësim të dhënash” për periudhën 1999-2003, të administruar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 04.01.2019. Kjo shkresë u kërkuar kryesisht nga trupi gjykues me vendimin e ndërmjetëm të datës 18.12.2018 për saktësim. Drejtoria Rajonale e Tatimeve {***} informon se pas verifikimit në sistemin C@ts u konstatua që subjekti F.B. është regjistruar më datën 28.03.2003 dhe ka kaluar në statusin pasiv më datën 04.05.2012, me objekt aktivitete juridike. Në sistemin C@ts nuk ka asnjë të dhënë pasi subjekti nuk ka bërë asnjë deklaram, ndërkohë që nga të dhënat e disponuara në arkiv, rikonfirmohen të dhënat e dërguara me shkresën nr. {***} prot., datë 08.02.2018 (e administruar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me nr. {***} prot, datë 13.02.2018 – fashikulli nr. 2, faqe 178), ku për periudhën 1999-2003, vlera në total e parashikimit është 2.364.000 lekë; vlera në total e qarkullimit është 3.164.000 lekë dhe vlera në total e pagesave është 344.670 lekë (të dhëna të verifikuara në dosjen e tatimpaguesit dhe kontabilitetit). Shkresë e kërkuar kryesisht nga trupi gjykues me vendimin e ndërmjetëm të datës 18.12.2018 për saktësim. Shih paragrafin 18, pika “iii” më sipër.

⁷⁶ Sipas dokumentacionit të administruar në arshivë, bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 08.02.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve {***}.

⁷⁷ Paragrafi 13.2, pika 22.

të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, nuk ndikon në marrjen e vendimit e, si rrjedhojë, pa vlerë provuese, siç përcaktohet në nenin 49, pika 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.⁷⁸

Në këtë analizë, trupi gjykues vëren se përkundër pretendimit të subjektit se shkresat zyrtare duhen marrë me rezerva dhe se ka vend të zbatohet neni 32, pika 2⁷⁹ për dokumentacion të munguar ose të zhdukur për shkak të trazirave të vitit 1997, trupi gjykues vëren se dokumentacioni i sjellë nga subjekti, me përjashtim të shkresës nga BKT (paragrafi 13.2, pika 18) dhe shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {***} (paragrafi 13.2, pika 10), në kontekstin e humbjes së pasurive të prindërve në vitin 1997 në firmat piramidale, rezultuan me peshë të kufizuar provuese.⁸⁰ Asnjë nga shkresat e tjera, përfshirë ato të sjella nga subjekti apo ato të kërkuara në procesin e rivlerësimit nga Komisioni apo Kolegji, nuk i atribuojnë trazirave apo kohës mungesë dokumentacioni. Vlen të përmendet që si gjatë hetimit në Komision por edhe nga vetë subjekti, janë mbledhur dokumente që provojnë pagimin e detyrimeve tatimore nga i ati i subjektit në vitin 1996, përpara trazirave të vitit 1997, që nga përmbajtja, për sa i përket periudhës kohore që dëshmojnë, janë në kontradiktë me pretendimin e subjektit se është në pamundësi objektive. Për këtë arsye, trupi gjykues çmon se ky pretendim i subjektit nuk qëndron.

23.17. Në vlerësimin e akteve shkresore, trupi gjykues çmoi nga njëra anë ekzistencën e llogarisë bankare në vitin 2006 (tërhequr tërësisht shuma e depozituar në vitin 2007) të *personit tjetër të lidhur* (nëna e subjektit të rivlerësimit),⁸¹ dhe faktin që kjo e fundit në vitin 2005 ka marrë një rimbursim për një pjesë të fondeve të humbura gjatë operimit në Shqipëri të firmave piramidale – dokumentuar nga subjekti i rivlerësimit me një mandatpagesë⁸². Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren edhe faktin që të dyja këto ngjarje kanë ndodhur në një periudhë kohore që daton shumë më herët (vitet 2005-2007) nga dhurimi i shumës prej 1800000 lekësh i vitit 2016, periudhë gjatë së cilës personi tjetër i lidhur ka jetuar me pensionin e saj.

23.18. Përkundër sa pretendoi subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, trupi gjykues vëren se kontrata e huas mes *personit tjetër të lidhur*, E.B., dhe H.B., për vlerën e 4.000.000 lekëve të kthyera në vitin 2013, sjellë si provë nga subjekti për të dokumentuar ekzistencën e burimeve

⁷⁸ Neni 49, pika 6, germa “d” parashikon: “[...]Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit. [...]”.

⁷⁹ Neni 32, pika 2 parashikon: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. [...]”.

⁸⁰ Paragrafi 13.2, pika 10, nr. {***} prot., A.T., datë 21.11.2018, që vërteton se dokumentacioni i pagave deri në shkurt 1998 nuk disponohet për shkak të trazirave. Vërtetimi nr. {***} prot., datë 08.11.2018, i Prokurorisë së Përgjithshme (paragrafi 13.2, pika 11) e bëri të panevojshme këtë provë.

⁸¹ Në vendimin e Komisionit, në faqet 14-15 citohet: “[...] znj. E.B. ka pasur llogari bankare pranë kësaj banke në monedhën euro, me vlerë fillestare në datë 13.3.2006 në shumën 12.000 euro. Nga gjendja e llogarisë rezulton se më datë 15.05.2006 është tërhequr shuma 10.000 euro dhe më datë 23.02.2007 është tërhequr shuma e mbetur prej 2.000 eurosh. Me shkresën e datë {***} të bankës “Raiffeisen” rezulton se znj. E.B. ka pasur llogari në lekë, hapur më datë 05.04.2007 dhe mbyllur më datë 16.1.2017, me vlerë fillestare 500.000 lekë. [...]”.

⁸² Shih paragrafin 13.2 të këtij vendimi, pika 34.

financiare të mjaftueshme të nënës së saj në vitet e ndërmjetme 2003-2016, pavarësisht nga dhe duke mos paragjykuar vlerën provuese dokumentare për huan mes dy palëve kontraktore të përfshira në të, nuk përmbush detyrimet e nenit 32, pika 4 e ligjit, për sa i përket provimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të këtyre pasurive dhe nuk përmbush kushtet e pajtueshmërisë me provat e tjera sipas nenit 49, pikat 4 dhe 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016⁸³, pasi është në kontradiktë me dokumentacionin zyrtar të administruar në fashikull, lidhur me të ardhurat e familjes B. nga aktiviteti privat i babait të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2003 si avokat dhe, për pasojë, nuk ndikon në vendimmarrjen për rivlerësim. (Për një analizë të detajuar të përlllogaritjeve të burimeve financiare të ligjshme të dokumentuara, shih paragrafin 26.)

ii) Mbi verifikimin e burimit të ligjshëm të shumës në vlerën 3.160.000 lekë, përfituar nga subjekti i rivlerësimit si e ardhur nën regjimin ushqimor

24. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se të ardhurat e siguruara nga ish-bashkëshorti i subjektit nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, Komisioni nuk ka administruar asnjë dokument provues dhe se mosjustifikimi i ligjshmërisë së këtyre të ardhurave ndikon dhe reflektohet edhe në analizën financiare mbi likuiditetet e subjektit dhe burimit të krijimit të asetit, makinë, të cilat rezultojnë negative për vitet 2011-2015, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

24.1. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se nuk provohet me dokumentacion ligjor marrja e pensionit ushqimor nga ana e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Po aty, Komisioni konstatoi se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk justifikon ligjshmërinë e të ardhurave të dhëna si pension ushqimor, si dhe ka mungesë burimesh financiare për dhënien e këtij pensioni dhe subjekti ka mospërputhje në deklarime në lidhje me shumën totale të përfituar si pension ushqimor. Pavarësisht nga konstatimet e tij se nuk u vërtetua me dokumentacion aftësia paguese e ish-bashkëshortit për pensionin ushqimor, pasi vlerësoi edhe parashtrimet e paraqitura nga subjekti, Komisioni argumentoi gjithsesi se kjo barrë nuk mund t’i ngarkohet subjektit të rivlerësimit. Ndërsa lidhur me blerjen e makinës nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 duke përdorur, sipas pretendimit të tij, një pjesë të të ardhurave nga pensioni, Komisioni arsyetoi se duke qenë se përgjatë viteve 2007-2011, ish-bashkëshorti nuk ka kryer asnjë pagesë dhe rritja e fëmijëve është përballuar nga vetë subjekti me të ardhurat e tij, është lehtësisht e kuptueshme që ky subjekt do të kishte pasur mundësi të kursente shumën prej 20.000 lekësh në muaj, që do t’i kishte marrë në mënyrë hipotetike nga ish-bashkëshorti.

24.2. Nga ana tjetër, Komisioneri Publik parashtrroi se barra për justifikimin e ligjshmërisë duhet t’i kalonte si subjektit, ashtu edhe ish-bashkëshortit. Ky i fundit duhet të ishte trajtuar në cilësinë e personit tjetër të lidhur. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, dhe ish-bashkëshorti i saj nuk arritën të provojnë nëse këto të ardhura kanë pasur burim të ligjshëm, fakt ky i cili passjell dhe diskutimin nëse kjo e ardhur duhet t’i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

⁸³ Neni 49, pika 4 parashikon: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelit bazojnë vendimin e tyre vetëm në [...] prova që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. [...]”.

24.3. Trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos hetojë për të ardhurat e përfituara nga pensioni ushqimor nga z. K.B. për disa arsye. Së pari, trupi gjykues vëren detyrimet ligjore të prindërve për rritjen e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre, siç ka vendosur edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor {***}, me vendimin nr. {***}, datë 27.02.2007. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren që gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision, z. B. ka pranuar që vlerat monetare me të cilat ka kontribuar për të përmbushur detyrimin e tij, vijnë nga burime të ndryshme⁸⁴. Deklarata noteriale e z. B., e datës 23.01.2017 [nr. {***} rep., nr. {***} kol,⁸⁵], pretendon se meqenëse fëmijët janë rritur dhe shpenzimet janë shtuar, ai paguan si pension ushqimor 30000 lekë dhe 20000 lekë në muaj, respektivisht për secilin fëmijë, dhe se pagesa prej 50000 lekësh ka filluar të kryhet nga janari i vitit 2015 e do të vazhdojë deri në përfundimin e studimeve të larta të fëmijëve, por nuk është shoqëruar me asnjë dokument provues të kryerjes reale të pagesave të pretenduara në vlerën 50000 lekë. Po ashtu, nga hetimi i kryer në Komision, nga korrespondenca me institucionet zyrtare⁸⁶ rezulton se megjithëse z. B. është avokat i licencuar, nuk ka gjurmë të pagesave nga ana e tij të detyrimeve sipas nenit 32, pika 4 dhe nuk ka dokumentacion ligjor provues të të ardhurave të tij, çka bën që nga njëra anë ai ndodhet në pamundësi që të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave dhe, nga ana tjetër, në pamundësi të të provuarit që ka krijuar realisht të ardhura. Kjo është sidomos në kontrast me pretendimin e subjektit për pagesë nga ana e ish-bashkëshortit, konsiderueshëm përtej shumës prej 20000 lekësh të vendosur nga vendimi i gjykatës, që përcaktoi detyrimin nën regjimin ushqimor në vitin 2007. Për këto arsye, duke mbajtur parasysh nga njëra anë faktin që ky detyrim i z. B. bazohej në një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe, nga ana tjetër, faktin që subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti nuk provuan burimin e ligjshëm të të ardhurave që shërbyen si bazë e kësaj pagese që konsiston edhe në tejkalim të vendimit të gjykatës, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të kryer nga Komisioni dhe të dhënave të përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar në atë fazë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se burimi i ligjshëm për për sa i përket shumës prej 720.000 lekësh, pretenduar nga subjekti dhe përfitur në

⁸⁴ *Shih deklarimet e K.B. në Komision, të administruara në fashikullin nr. 4, faqe 445-446, ku në procesverbalin e mbajtur, pyetjeve “[...] Midis 2007-2010, kishit vështirësi për pagesën e fëmijëve? [...] Si e mblodhët shumën prej 10 milionë lekësh? [...] Nga kjo shumë, sa borxhe keni marrë? [...] Pse nuk i mblodhët lekët më përpara, por në vitin 2011?” – ai shprehet: “[...] Po kam pasur, më kanë ndihmuar miq, shokë, kolegë. [...] Në vitin 2011 e krijova mundësinë për t’i paguar. Një (1) milion lekë ia dhashë së bashku kompensimin në fund të shtatorit. Paratë i mblodha nga fundi i vitit 2010 deri më 2011 [...] nga puna si avokat, nga miq nga kolegë [...] 40 për qind i kisha vetë, 60 për qind borxh. [...] Edhe kolegët kanë pasur probleme, por në atë kohë e gjetën mundësinë [...]”.*

⁸⁵ *Shih deklaratën e administruar në fashikullin nr. 5, faqe 584.*

⁸⁶ *Shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore {***} nr. {***} prot., datë 06.04.2018, sipas së cilës “[...] K.B. është regjistruar si person fizik me objekt aktivitete juridike, me status pasiv që më datë 19.03.2013 [...]” dhe se “[...] nga verifikimi në sistemin c@tas rezulton se ky subjekt nuk ka dorëzuar asnjë deklaratë tatimore apo të deklaruar online. Gjithashtu, për këtë subjekt, ky institucion nuk disponon asnjë dokumentacion në arshivë [...]” – shih fashikullin nr. 2, faqe 173.*

*Shkresa e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale {***}, nr. {***} prot., datë 27.03.2018, bën me dije se K.B. nuk figuron i regjistruar në asnjë subjekt nga janari 2012 deri në janar 2018, sipas të dhënave të sistemit informatik të tatimeve CMIS – shih fashikulli nr. 2, faqe 198.*

*Shkresa të Qendrës Kombëtare të Biznesit nr. {***} prot., datë 28.12.2017, bashkëlidhur së cilës gjendet ekstrakti historik i personit fizik K.B. (datë 28.12.2017), sipas të cilit rezulton i regjistruar si person fizik, prej datës 01.10.2007, në fushën e veprimtarisë së avokatisë, me status aktiv – shih fashikulli nr. 2, faqe 203-205.*

tejkalim të detyrimit të ish-bashkëshortit për regjim ushqimor, mbeti i paprovuar me dokumentacion të rregullt ligjor.

24.4. Trupi gjykues i Kolegjit vëren po ashtu mospërputhje në deklaratimet ndër vite, si dhe në ato të kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, por edhe më tej, në shpjegimet e dhëna gjatë procesit të hetimit, lidhur me vlerën e detyrimit ushqimor të përfituar nga ish-bashkëshorti. Më konkretisht, ndërsa në deklaratën *vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka përfituar detyrim ushqimor nga ish-bashkëshorti shumën 1.960.000 lekë për periudhën 2007-2014 dhe 1.200.000 lekë për periudhën 2015-2016 – në total 3.160.000 lekë – kjo vlerë bie ndesh me deklaratimet e subjektit gjatë deklaratave periodike ndër vite dhe shpjegimeve të tij të datës 21.5.2018, gjatë hetimit administrativ në Komision⁸⁷. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi të përfshinte në analizën financiare të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit vetëm shumën që korrespondon me vlerën e detyrimit ushqimor, të caktuar me vendimin nr. {***}, datë 27.02.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {***}, i formës së prerë, në vlerën 20.000 lekë në muaj, në total 2.360.000 lekë⁸⁸. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se burimi i ligjshëm për shumën prej 720.000 lekësh, pretenduar nga subjekti dhe përfituar në tejkalim të detyrimit të ish-bashkëshortit për regjim ushqimor për vitet 2015-2016, mbeti i paprovuar me dokumentacion të rregullt ligjor, sikurse është argumentuar në paragrafin 24.3 të këtij vendimi.

iii) *Mbi verifikimin e saktësisë së deklaratimit dhe mjaftueshmërinë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar kursimet e deklaruara në formën e likuiditetit cash jashtë sistemit bankar në vitet 2014 dhe 2015*

25. *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit prej deklaratimit të parë të interesave privatë (2007) e në vijim ka qenë i pasaktë dhe ka kryer deklaratim të rremë, reflektuar edhe në deklaratën *vetting*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

25.1. Komisioni arsyetoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklaratimin ndër vite për sa u përket shtesave dhe pakësimeve nga të ardhurat, pasaktësi të cilat kanë ndikuar dhe në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në vitet 2009 dhe 2012 dhe se ka mungesa të ardhurash në shuma të papërfillshme, të cilat janë rrjedhojë e mosdeklarimit të shtesave dhe pakësimeve nga të ardhurat ndër vite, përkatësisht për vitet 2011-2013 në shumën prej 22.797 lekësh, si dhe në vitet 2014-2015 në shumën 39.749 lekë.

25.2. Nga ana tjetër, Komisioneri Publik parashtroi se treguesit e analizës financiare rezultojnë negativë dhe veçon disa vite, në të cilat deklarohen kursime *cash*, hua, dhurim dhe blerje pasurie,

⁸⁷ Në deklaratën e vitit 2016 ka deklaruar të ardhura nga pensioni ushqimor në shumën 600.000 lekë; në deklaratën e vitit 2015 ka deklaruar të ardhura nga detyrimi ushqimor në shumën 240.000 lekë; në deklaratën e vitit 2014 ka deklaruar të ardhura nga detyrimi ushqimor në shumën 240.000 lekë; në deklaratën e vitit 2013 ka deklaruar të ardhura nga detyrimi ushqimor në shumën 620.000 lekë, për periudhën qershor 2011 – dhjetor 2013 (31 muaj derdhur në këste); në deklaratën e vitit 2012 ka deklaruar të ardhura nga detyrimi ushqimor në shumën 240.000 lekë; në deklaratën e vitit 2011 ka deklaruar 1.000.000 lekë të ardhura nga detyrimi ushqimor, të palikuiduara për vitet mars 2007 – maj 2011, gjithsej 50 muaj; në deklaratat për vitet 2007-2010 nuk ka deklaruar asnjë të dhënë për detyrimin ushqimor.

⁸⁸ Për periudhën mars 2007 – dhjetor 2016.

për të provuar që subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi dhe me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara, të cilat më pas (shuma 1,7 milionë lekë) kanë shërbyer për shlyerjen e huas. Më konkretisht:

- i) për vitin 2014, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, ka deklaruar kursime *cash* në shumën 1,1 milionë lekë, ajo rezulton në pamundësi dhe me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për një diferencë negative në shumën 607.505 lekë (gjashtëqind e shtatë mijë e pesëqind e pesë lekë);
- ii) për vitin 2015, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit deklaron blerjen e pasurisë apartament në Tiranë dhe deklaron sërish kursime *cash* në shumën 1,1 milionë lekë, subjekti rezulton në pamundësi dhe me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për një diferencë negative në shumën 1.444.602 lekë (një milion e katërqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e dy lekë);
- iii) për vitin 2016, diferenca negative rezulton në shumën 2.768.193 lekë (dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre lekë). Kujtojmë se në këtë vit, subjekti deklaron se ka shlyer huan ndaj personit tjetër të lidhur, tezes së saj, në shumën 25.000 euro, me burim kursimet *cash* të deklaruara në vitet e sipërcituara, 2014 dhe 2015, si dhe shuma prej 1,8 milionë lekësh, e deklaruar si dhurim nga personi tjetër i lidhur, nëna e subjektit të rivlerësimit.

25.3. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, vëren se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi financiare për të siguruar gjendjen e deklaruar *cash* në vitet 2014 dhe 2015, në shumën 1.100.000 në secilin vit, pasi situata financiare tregon mosmbulim me të ardhura të ligjshme në vitin 2014 në vlerën 607.505 lekë dhe në vitin 2015 në vlerën 1.444.602 lekë.

25.4. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit me këtë deklaram të bërë për vitet 2014 dhe 2015, duke qenë në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, ka kryer deklaram të rremë, sikurse parashikon neni 33, pika 5, geramat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

26. Përkundër pretendimit të subjektit se Komisioneri Publik u shpreh për likuiditetet në shumën 1,7 milionë lekë vetëm pasi trupi gjykues vendosi të mos hetojë për burimin e ligjshëm të të ardhurave të ish-bashkëshortit në seancën e datës 18.12.2018, trupi gjykues vëren se ky pretendim i subjektit nuk qëndron. Komisioneri Publik, së pari e ka përfshirë analizën e likuiditeteve në ankimin e datës 14.08.2018 në paragrafin 16.4.4, dhe më tej e ka rikonfirmuar kërkesën për hetim nga Kolegji në parashtrimet e tij të seancës publike të datës 13.12.2018⁸⁹ dhe në parashtrimet e tij të seancës publike të datës 18.12.2018⁹⁰ – përpara vendimit të ndërmjetëm të marrë nga trupi gjykues.

⁸⁹ Faqja 6, rreshti 7, rubrika “Kërkime”.

⁹⁰ Faqja 6, rreshti 23 i parashtrimeve të Komisionerit Publik në seancën e datës 18.12.2019.

26.1. Pas analizës financiare të kryer në Kolegj, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi me burime të ligjshme shumë prej 5.318.061 lekësh për të gjithë periudhën, 2007-2016, duke përfshirë në përllogaritje të gjitha kërkimet e Komisionit Publik, konkretisht: për vitin 2016, diferenca e pambuluar është në vlerën 2.515.206; për vitin 2015, diferenca e pambuluar është në vlerën 1.444.602 lekë; për vitin 2014, diferenca e pambuluar është në vlerën 607.505 lekë; për vitin 2013, diferenca e pambuluar është në vlerën 495.277 lekë dhe për vitin 2010 diferenca e pambuluar është në vlerën 255.471 lekë. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, u mbajtën në konsideratë:

1. vlerat e të ardhurave nga pagat për subjektin e rivlerësimit, të marra nga vërtetimet e pagave, përcjellë nga institucionet përkatëse, verifikuar me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
2. vlerat e të ardhura nga pensioni për nënën E.B. janë marrë nga shkresat e përcjella nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore {***} dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit;
3. vlera e të ardhura nga pensioni ushqimor nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është përllogaritur në bazë të vendimit nr. {***}, datë 27.02.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i formës së prerë, për përcaktimin e detyrimit ushqimor me zgjidhjen e martesës;
4. vlerat e të ardhurave nga shitja e makinës, Volkswagen Golf, në vlerën 100.000 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.08.2012;
5. vlera e kredisë nga Alpha Bank, sipas kontratës së huas nr. {***}, datë 22.09.2015, noterizuar me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2015, në vlerën 7.000.000 lekë (ekuivalente me vlerën 50.000 euro);
6. vlera e huas e marrë nga znj. D.P. në shumë 25.000 euro, ekuivalente me vlerën 3.441.250 lekë (konvertuar me kursin e këmbimit 1 euro = 137,28 lekë) dhe të konfirmuara nga transaksionet bankare;
7. vlera e pakësimi i gjendjes së *cash*-it të përdorur për mbulimin e shpenzimeve në vitet 2015 dhe 2016;
8. vlera e të ardhurave për periudhën 1966-1991 është e pakonsiderueshme dhe nuk ka efekt financiar, pasi për këtë periudhë shpenzimet për jetesë janë konsideruar nga Kolegji në masën 100% të të ardhurave⁹¹;
9. vlera e të ardhurave të përfituara nga dhurimi i znj. E.B. në shumë 1.800.000 lekë, të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2016, si dhe në deklaratën *vetting* të subjektit të rivlerësimit, janë konsideruar në shumë 555.637 lekë, sipas vlerës së rezultuar nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve për z. F.B. dhe znj. E.B., kundrejt të ardhurave të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore {***}⁹²;

⁹¹ Shih poshtëshënimet për paragrafin 23.14.

⁹² Shih shkresën nr. {***} prot., datë 28.12.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve {***}, me lëndë "Saktësim të dhënash" për periudhën 1999-2003, të regjistruar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 04.01.2019. Analiza financiare në Kolegj për këtë çështje u mbështet në të ardhurat e vërtetuara: i) të z. F.B. në profesionin e avokatit; ii) të znj. E.B. nga punësimi në shtet; iii) të znj. E.B. nga pensioni i përfutur prej saj dhe iv) të ardhurat nga kthimi i lekëve nga shoqëria {***}; si dhe në shpenzimet e jetesës: i) në masën 50% të të ardhurave për periudhën 1993-1999; ii) sipas KPK-së për periudhën 1999-2002; iii) sipas metodologjisë së ILDKPKI-së referuar të dhënave të

10. vlera e shpenzimeve për blerjen e apartamentit, blerë me kontratë shitblerjeje me rezervë nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.09.2015, në vlerën 80.000 euro [ekuivalente me shumën 11.120.250 lekë (shumë e përbërë nga vlera e kredisë prej 7.000.000 lekësh, me vlerën e huas së marrë nga D.P. prej 3.432.000 lekësh, si dhe vlerën reale që mund të kishte mundësi të kursente në shumën 492.495 lekë, duke qenë në pamundësi *cash*-i, ndërkohë që vetë subjekti i rivlerësimit deklaron pagesën nga kursimi në shumën prej 5.000 eurosh, ekuivalente me 688.250 lekë;
11. vlera e shpenzimeve për blerjen e makinës Mazda 3, me vlerë 15.900 euro, blerë me kontratë blerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 14.05.2013, kaluar pronësia nga “Raiffeisen Leasing” te Alma Brati, sipas transaksioneve të shlyerjes së detyrimeve të konfirmuara nga transaksionet bankare, me vlerë totale 2.397.467 lekë;
12. vlera e shpenzimeve për shlyerjen e kredisë për rikonstruksionin e banesës në Durrës (në bashkëpronësi, pjesë 25%), të evidentuara sipas konfirmimeve bankare të lëshuara nga Banka Intesa Sanpaolo;
13. vlera e shpenzimeve për qira mujore, për periudhën korrik 2007 deri në tetor 2015, janë marrë sipas deklarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit;
14. vlera për zërin “Gjendja e *cash*-it” është marrë sipas vlerave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e pasurisë të viteve 2014 dhe 2015;
15. vlera e shlyerjes së huas ndaj znj. D.P., sipas deklaratës periodike të vitit 2016, e konfirmuar edhe me deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 20.02.2016, të subjektit të rivlerësimit mbi shumën e shlyer;
16. vlera e shpenzimeve për shlyerjen e kësteve të kredisë për blerjen e apartamentit me vlerë totale prej 634.767 lekësh, është vendosur sipas transaksioneve të konfirmuara me dokumentacion bankar lëshuar nga Alpha Bank;
17. kostot e udhëtimeve jashtë vendit, sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti gjatë procesit të hetimit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për periudhën 1 janar 2011 – 31 dhjetor 2015;
18. vlera e shpenzimeve për mobilim, sipas vlerave dhe shpërndarjes në vite të deklaruara nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit në Komision;
19. vlera e shpenzimeve për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ish-bashkëshortit dhe znj. E.B., sipas dokumentacionit të përcjellë në Kolegj nga Zyra Vendore e Pasurive të Paluajtshme {***} me pagesën totale prej 161.755 lekësh, ku subjekti posedon 25% dhe nëna e saj, znj. E.B., posedon 50% të pasurisë;
20. vlera e shpenzimeve për konsum familjar, prej 4 personash, pasi subjekti ka jetuar me bashkëshortin deri në datën 27.02.2007, datë e dhënies së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {***} për zgjidhje martesë, si dhe ka deklaruar se prej muajit korrik 2007 jeton me nënën e saj, znj. E.B., të përllogaritura me të njëjtën metodologji të përdorur nga ILDKPKI-ja, referuar të dhënave të INSTAT-it, si i vetmi institucion përgjegjës dhe i specializuar në

INSTAT-it, për periudhën 2003-2007; si dhe në shpenzimet e vërtetuara/dokumentuara për blerjen e shtëpisë dhe shlyerjen e kredisë për rikonstruksionin e shtëpisë në Durrës.

Republikën e Shqipërisë për treguesit statistikorë të konsumit vjetor dhe mujor për familje dhe për frymë;

21. vlera e likuiditeteve në bankë, sipas dokumentacionit bankar të disponuar në dosje, të llogarive bankare pranë bankave “Raiffeisen” dhe “Alpha”, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur numra llogarie të hapur (diferenca e gjendjes në fillim të vitit me gjendjen në fund të vitit në llogaritë bankare të subjektit).

27. Në kushtet kur Komisioneri Publik hoqi dorë nga shkaqet e ankimit që lidheshin me mospërputhjen mes sipërfaqes së regjistruar në titull me atë të disponuar në kontratën e shitblerjes së pasurisë në Durrës dhe marrëdhënies së huas për shumën 3200 euro, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi të mos kryejë hetime, duke i përjashtuar këto dy çështje nga shkaqet e shqyrtimit në dhënien e vendimit për subjektin e rivlerësimit.

c) Mbi denoncimet e publikut të depozituara në Kolegj ndaj subjektit të rivlerësimit

28. Pranë Kolegjit, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit kanë ardhur denoncimet si më poshtë:

- denoncimi i B.R., i depozituar më datë 30.07.2018;
- denoncimi i S.I., i depozituar më datë 15.08.2018, 12.12.2018, 14.12.2018 dhe 22.02.2019;
- denoncimi i M.B., i depozituar më datë 02.11.2018;
- denoncimi i K.Ç., i depozituar më datë 11.04.2019;
- denoncimi i B.T., i depozituar më datë 15.04.2019⁹³.

28.1. Këto denoncime të publikut iu njoftuan edhe palëve në proces, të cilat parashtuan qëndrimin e tyre për çështjet e pretenduara në denoncim.

28.2. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre denoncimeve, trupi gjykues konstatoi se përgjithësisht ato lidheshin me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Ky kriter nuk ka qenë pjesë e ankimit të Komisionerit Publik, e rikonfirmuar prej këtij të fundit në seancën publike të datës 11.03.2019.

28.3. Për sa u përket dy denoncimeve që paraqisnin të dhëna identike mes tyre – ndonëse në dukje dy persona të ndryshëm (B.T. dhe K.Ç) – për një nga shkaqet e ankimit, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mos kryejë hetime, pasi konstatoi se, parë në këndvështrimin e kërkesave të nenit 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për fakte që “[...] përbëjnë prova për kriteret e rivlerësimit [...]”, meqenëse vetë trupi gjykues kishte ndërmarrë hapa për të kryer hetime në atë kriter, informacioni i pretenduar u çmua i panevojshëm, i provuar gjatë gjykimit dhe marrja e provave ishte tërësisht e paarritshme.⁹⁴

29. Duke vlerësuar në tërësi se këto denoncime nuk përmbanin fakte apo rrethana të cilat mund të përbënin provë në këtë proces gjyqësor, në përputhje me nenin 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe

⁹³ Pranë Kolegjit, në datën 05.06.2019 u administrua denoncimi i Xh. K., i cili nuk iu nënshtrua shqyrtimit gjyqësor pasi nuk plotësonte kushtet ligjore.

⁹⁴ Neni 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht gërmat “a”, “b”, “c”.

me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues u shpreh për mosçeljen e hetimit gjyqësor⁹⁵.

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 33, pika 5, germa “b”, të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2014 vlerëson se vendimi nr. 32, datë 05.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mbështetur në faktet e provuara në gjykim dhe në ligjin e zbatueshëm për çështjen, sipas nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot në Tiranë, më datë 09.07.2019.

GJYQTARE

Ina Rama

nënshkrimi

GJYQTAR

Luan Daci

nënshkrimi

GJYQTARE

Albana Shtylla

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta Schuetz

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

⁹⁵ Vendimi i dhënë në seancat gjyqësore të datës 11.03.2019 dhe 26.04.2019.

MENDIM PARALEL

1. Në cilësinë e anëtares/kryesueses së trupit gjykues, kam votuar pro vendimit të marrë nga shumica për çështjen (JR) nr. 13, datë 07.09.2018, me ankimues Komisionerin Publik, kundër vendimit nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati.

Nuk jam dakord me metodologjinë e përdorur në analizën financiare të kryer në Kolegj për përllogaritjen e shpenzimeve për konsum familjar për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

Lidhur me shpenzimet për konsum familjar, si zë i shpenzimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, parashikuar nga neni 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016 për periudhën e analizuar, në ndryshim nga vendimi i shumicës, vlerësoj se duhet të përllogariten sipas të dhënave të “Shpenzimeve mujore për konsum sipas madhësisë së Njësisë Ekonomike Familjare” (NjEF), publikuar nga Instituti i Statistikave (në vijim INSTAT), si i vetmi institucion zyrtar përgjegjës dhe i specializuar në Republikën e Shqipërisë, bazuar në ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004, “Mbi statistikën zyrtare”, i ndryshuar, të afektuara me të dhënat e “Shpenzimeve mujore për konsum sipas qarqeve”⁹⁶, publikuar nga INSTAT, afektuar me inflacionin e përllogaritur me ndryshimet mesatare vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit, të publikuar gjithashtu nga INSTAT⁹⁷.

2. Sa u përket viteve për të cilat INSTAT-i nuk ka publikuar të dhëna për shpenzimet e jetesës/për konsum, bazë për llogaritjen e kostove të jetesës/shpenzimeve për konsum familjar, duhet të jenë të dhënat e vitit paraardhës ose pasardhës më të afërt, të afektuara me inflacionin e përllogaritur në ndryshimet mesatare vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit, afektuar me shpenzimet mujore për konsum sipas qarqeve.

Metodologjia e përdorur nga shumica e anëtarëve të trupit gjykues, për të përllogaritur kostot e shpenzimeve për konsum vjetor dhe mujor për familje dhe për frymë për vitin 2000, është bazuar në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes (ABF 2000), të aplikuar vetëm në zonat urbane, kurse për vitet 2002, 2005, 2008 dhe 2012, është bazuar në të dhënat e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës (në vijim “AMNJ”), AMNJ 2002, AMNJ 2005, AMNJ 2008 dhe AMNJ 2012) në nivel vendi. Për vitin 2006 i është referuar AMNJ 2005, për vitin 2007 u është referuar të dhënave të marra nga ABF 2006-2007, për vitin 2009, 2010, 2011 i është referuar AMNJ 2008, për vitin 2013 i është referuar AMNJ 2012, për vitin 2014 i është referuar ABF 2014, 2015 dhe 2016 përkatësisht, ndërkohë që të dhënat e konsumit të të dyja anketave të sipërcituara nuk janë të krahasueshme për shkak të burimeve të ndryshme të prodhimit, si dhe metodologjive të ndryshme të aplikuar.

3. Në përmbledhje të sa më sipër, e mbaj këtë qëndrim, pasi, *së pari*, të dhënat për përllogaritjen e kostove sipas shumicës së anëtarëve, të shpenzimeve për konsum familjar, janë marrë për periudha të ndryshme nga anketa të ndryshme, pra baza e krahasimit nuk është e njëjtë. *Së dyti*, për vitet 2002, 2005, 2008 dhe 2012, të dhënat për shpenzimet mesatare mujore për konsum për frymë, janë marrë nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, e cila, nga analizimi i metodologjisë së aplikuar dhe *variablave të përdorura në matjet statistikore*, si për shembull treguesit e varfërisë, sipas qarqeve dhe rajoneve, ka pasur si qëllim llogaritjen e treguesve të nivelit të

⁹⁶ www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-te-familjes/#tab2

⁹⁷ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_PR_PRCPI/CPI006/?rxid=ee798d2-a24d-44f0-9c9c-3909a5be39bd

jetesës, matjen e varfërisë, studimin e trendit të zhvillimit ekonomik dhe social të 12 qarqeve të Shqipërisë, *por jo konsumin drejtpërdrejt*.

4. Gjykoj se të dhënat sa me sipër nuk pasqyrojnë konsumin mesatar mujor, familjar të subjekteve të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë nivelin e të ardhurave mujore të tyre. Referuar AMNJ 2002, shpenzimet mesatare për konsum mujor për frymë në rajonin e Tiranës kanë qenë 9.042 lekë. E ardhura mujore nga paga bruto për një gjyqtar në Tiranë, në vitin 2002, ka qenë 53.790 lekë⁹⁸, e përlogaritur neto 46.898 lekë⁹⁹. Nga përlogaritjet e kryera sipas shumicës së anëtarëve të trupit gjykues, bazuar në të dhënën e konsumit për frymë të Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ 2002) më sipër, një gjyqtar rezulton të ketë shpenzuar mesatarisht në muaj vetëm 19% të të ardhurave të tij mujore, dhe diferencën prej 81% ta ketë kursyer, gjë e cila është pothuajse e pamundur.

Së treti, sa u përket viteve për të cilat INSTAT-i nuk ka publikuar të dhëna lidhur me shpenzimet për konsum familjar, shumica e trupit gjykues ka përdorur të dhënat e vitit të mëparshëm, konkretisht të dhënat e anketës së vitit 2008, të cilat janë përdorur për përlogaritjet e konsumit familjar për vitet 2009, 2010 dhe 2011, duke mos reflektuar kështu ndryshimin e çmimeve të mallrave të shportës dhe efektin e ndryshimeve të normës së inflacionit për periudhën 2008-2011.

5. Në mbështetje të arsytimit të mësipërm, i jam bashkuar arsytimit të shumicës për të gjitha elementet e tjera të vendimit, duke përjashtuar këtë, por që gjithsesi nuk cenon votën time për të ndryshuar vendimin nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
6. Në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, jam dakord me të gjitha pjesët e vendimit përveç sa më sipër, lidhur me metodologjinë e përlogaritjes të shpenzimeve për konsum.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

⁹⁸ VKM nr. 299, datë 27.06.2002, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 36, korrik 2002.

⁹⁹ Ligji nr. 8889, datë 25.04.2002 dhe ligji nr. 8841, datë 11.12.2001.

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, po parashtroj më poshtë argumentet e një arsytimi paralel me arsyetimin e vendimit nr. 14 (JR), datë 09.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Arsyetimi i këtij mendimi paralel lidhet me qëndrimin ndryshe në raport me konkluzionin e mbajtur nga shumica e trupës gjyquese për sa u përket dy çështjeve:

2.1 Aftësisë së personit tjetër të lidhur, znj. E.B. (nëna e subjektit), për t’i dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën prej 1.800.000 lekësh.

2.2 Kualifikimit si deklaram i rremë i situatës së mungesës së burimeve financiare të ligjshme për vitet 2014-2015, sikurse parashikon neni 33, pika 5, geramat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

3. Kam mbështetur dhe kam votuar pro argumenteve të dhëna nga trupa gjyquese në analizë të shkaqeve të tjera të ankimit të paraqitura prej Komisionerit Publik dhe kam vlerësuar se me të drejtë ato të çojnë në ndryshimin e vendimit nr. 32, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).

Më poshtë po jap argumentet e mia për shkaqet dhe çështjet (paragrafët 2.1 dhe 2.2) për të cilat kam ndarë një qëndrim të ndryshëm nga qëndrimi dhe arsyetimi që ka bërë trupa gjyquese.

I

4. Nga hetimi administrativ ka rezultuar, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nëna e saj, znj. E.B., i ka dhuruar në vitin 2016 shumën prej 1.800.000 lekësh, të siguruar prej kursimeve në vite, të cilën subjekti e ka përdorur si burim për shlyerjen e një pjese të huas së dhënë prej tezes së saj, znj. D. P..
5. Komisioni e ka konsideruar këtë dhurim si të mbështetur në burime të ligjshme, duke pranuar se personi tjetër i lidhur (nëna) ka pasur mundësi të krijojë dhe kursejë këtë shumë, të cilën ia ka dhënë subjektit të rivlerësimit.
6. Komisioneri Publik e ka kontestuar këtë qëndrim të Komisionit duke pretenduar se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur mundësi që me burime të ligjshme të krijojë e kursejë këtë shumë. Kolegji, pas ndihmës së dhënë nëpërmjet analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor mbi të dhënat faktike që janë përdorur në këtë analizë, ka konkluduar se nëna e subjektit nuk ka pasur mundësi të kursejë shumën prej 1.800.000 lekësh në vitin 2016, por ka pasur mundësi të kursejë vetëm shumën prej 555.637 lekësh.
7. Kam ndarë qëndrim të ndryshëm nga anëtarët e tjerë të trupës gjyquese për disa arsye, të cilat lidhen në thelb së pari me trajtimin ligjor të personit tjetër të lidhur, si një subjekt i posaçëm i

procesit të rivlerësimit, dhe në vijim të këtij qëndrimi edhe me analizën dhe konkluzionin e nxjerrë për rastin konkret.

8. Me të drejtë, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. E.B., është konsideruar prej Kolegjit si person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), e cila parashikon: *Persona të tjerë të lidhur* janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, Komisionerin, Gjyqtarin ose Komisionerin Publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi, për shkak se marrëdhënia e dhurimit, e deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike të pasurisë të vitit 2016, konsiderohet në kuptim të kësaj dispozite një lidhje interesi që rrjedh nga një interes pasuror.
9. Ligji nr. 84/2016, përveç faktit të dhënies së përkufizimit për personin tjetër të lidhur, i cili është përveç të tjerave edhe një përkufizim referues për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ka përcaktuar në mënyrë specifike statusin e personit tjetër të lidhur kur ai shfaqet në cilësinë e dhuruesit, huamarrësit e huadhënësit në nenin 32, pika 4, ku parashikohet: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.*
10. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, mendoj se subjekti i rivlerësimit detyrohet për efekt të këtij procesi të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, detyrim i cili duhet të shtrihet deri në provimin e burimit të ligjshëm të asaj pasurie e cila ka përfshirë palët në këtë marrëdhënie, dhurimi apo huaje, pra te pasuria e dhuruar apo e dhënë hua. Ngarkimi i subjektit të rivlerësimit me detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të çdo pasurie që figuron në emër të personave të lidhur, duket se është një detyrim në tejkallim të ligjit dhe i shpërpjesëtuar. Në rastet e tilla, qëllimi i ligjit ka qenë të detyrojë subjektin që çdo pasuri që ai mban, qoftë si pronar apo qoftë si posedues, t’i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe kontrollit, pavarësisht se burimi i krijimit të saj është nga të ardhurat e subjektit apo nga të ardhurat e një personi tjetër, i cili më pas ia ka kaluar subjektit pronësinë apo posedimin.
11. Në vijim të këtij arsytimi, mendoj se objekt i verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së personit tjetër të lidhur, duhet të jetë vetëm pasuria objekt dhurimi apo huaje. Ky detyrim ligjor që i përket subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të cenoje apo të shmangë detyrimin që ka Komisioni apo Kolegji për të kryer hetime për çdo pasuri për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se mbahet në emër të personave të tjerë të lidhur apo shtetasve të tjerë, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 14 e këtij ligji.

12. Në këto rrethana, duke analizuar rastin konkret, kam arritur në një konkluzion të ndryshëm nga anëtarët e tjerë të trupës gjyquese për sa i përket aftësisë së personit tjetër të lidhur, znj. E. B., nëna e subjektit të rivlerësimit, për të krijuar pasurinë prej 1.800.000 lekësh, dhënë dhuratë së bijës.
13. Ndërkohë që trupa gjyquese është përqendruar tek analizimi i çdo të dhëne që lidhet me pasuritë apo shpenzimet e kryera nga personi tjetër i lidhur (nëna), për të konkluduar nëse kishte mundësi të kursente këtë shumë, mendoj se detyrimi i subjektit në këtë rast do të duhej të fokusohet te provimi i faktit nëse kjo shumë mund të krijohej me burime të ligjshme, duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet e familjes B. në një kontekst më të përgjithshëm dhe bazik, pikërisht për shkak të faktit se për të nxjerrë një konkluzion krejtësisht analitik e të detajuar për personat e tjerë të lidhur, do të duhej të analizohej çdo fakt i jetës së tyre që prodhon një efekt financiar, do të duhej të pyeteshin ata nëse ishin përfshirë në marrëdhënie kredie apo huaje apo në forma të tjera financimi përgjatë jetës së tyre, sa kishin udhëtuar, çfarë shërbimesh mjekësore, dhuratash apo ndihmash kishin marrë, në çfarë marrëdhëniesh biznesi, apo fitimprurëse, ishin përfshirë, e të tjera si këto, fakte të cilat janë të pamundura për t'u hetuar, duke pasur në konsideratë se rëndom këta persona nuk kanë qenë ndonjëherë subjekte deklarimi dhe, për më tepër, në tejkallim të detyrimeve që përcakton ligji nr. 84/2016.
14. Në lidhje me personin tjetër të lidhur, znj. E.B., rezulton se të ardhurat e saj të pretenduara prej subjektit të rivlerësimit dhe që kanë mundësuar krijimin e shumës prej 1.800.000 lekësh kursime, përbëhen nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit të ndjerë, nga paga dhe aktiviteti i tij si avokat për vitet 1996-2003.
15. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se mungon dokumentacioni i organeve tatimore që provon të ardhurat e z. B. si avokat për periudhën 1996-1998, kur ai ka kryer këtë aktivitet në qytetin e Shkodrës. Nëpërmjet shkresave të tatimeve dhe pretendimeve në gjykim, subjekti ka shpjeguar se për shkak të trazirave të ndodhura në këtë qytet në vitet 1997-1998, është djegur dhe nuk gjendet dokumentacioni i cili do të provonte këto të ardhura. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithsesi para Kolegjit një dokument që provon se z. F.B., babai i saj, është regjistruar si person fizik në organet tatimore që në vitin 1996¹⁰⁰. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe 17 vendime gjyqësore të gjykimeve të zhvilluara në vitet 1997-1998, në të cilat babai i saj ka marrë pjesë si avokat i palëve ndërgjyqëse. Një pjesë e tyre janë procese penale, në të cilat për shkak të pengesave të legjislacionit të kohës¹⁰¹, nuk mund të ishte në këtë rol nëse nuk ishte një avokat i regjistruar si person fizik në organet tatimore.

¹⁰⁰ Paraqitur një kopje e certifikatës së regjistrimit në Organin Tatimor, lëshuar nga Ministria e Financave, Dega e Tatim Taksave të Rrethit {***}, me kod fiskal {***} e me nr. serie {***}, në të cilët konfirmohet regjistrimi si avokat sipas vendimit të gjykatës nr. {***}, datë 06.08.1996, me seli përballë gjykatës. Periudha e veprimtarisë vjetore është nga 08.08.1996 deri më 31.12.1996. Bashkë me certifikatën e regjistrimit është dorëzuar dhe një mandat arkëtimi me vlerë 5.000 lekë, kryer në sportelet e Bankës Kombëtare Tregtare, {***}, i cili konfirmon kreditimin e shumës në llogarinë me nr. {***}, në emër të F. B., me qëllim çeljen e një llogarie bankare.

¹⁰¹ Në nenin 6 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet: "I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit, kur nuk ka mjete të mjaftueshme, i sigurohet mbrojtja falas me avokat." Ligji i kohës i

16. Mendoj që në këto rrethana, do të duhej të aplikohesh neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...] – dhe do të duhej të konsideroheshin të pranura pretendimet e subjektit për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, duke përdorur një metodologji analoge me atë të përdorur për përcaktimin e këtyre të ardhurave në vitet e afërta, sipas dokumentacionit tatimor¹⁰². Në këtë mënyrë do të duhej të pranohej se babai i subjektit të rivlerësimit ka realizuar të ardhura të ligjshme në masën: të paktën 198.498 lekë në vitin 1996; 463.163 lekë për vitin 1997 dhe 529.330 lekë për vitin 1998, të cilat në total janë 1.190.991 lekë; këto për vitet kur nuk është e mundur të ketë dokumentacion tatimor, ndërkohë që provohet ushtrimi i aktivitetit të avokatit dhe regjistrimi në organet tatimore.*
17. Gjithashtu, gjatë hetimit ka rezultuar se nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur të hapur në emër të saj një depozitë në Raiffeisen Bank me nr. {***}-ALL-{***}, të hapur datë 05.04.2007 dhe të mbyllur më 16.01.2017, në të cilën ka depozituar më datë 05.04.2007 shumën 500.000 lekë. Depozita është pakësuar në vlerë në datën 11.04.2008 (tërhequr shuma prej 396.000 lekësh) dhe mbetur në depozitë diferenca prej 104.000 lekësh deri në datë 14.04.2010. Depozita është mbyllur përfundimisht më datë 16.01.2017.
- Përveç sa më sipër, nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur një llogari pranë ProCredit Bank, me nr. {***}, çelur më datë 13.03.2006, me depozitim e shumës 12.000 euro, shumë e cila pjesërisht është tërhequr më datë 15.05.2006 (10.000 euro), duke lënë si depozitë bankare diferencën e mbetur prej 2.015 eurosh dhe interesat e përfituar deri më datën 23.02.2007, datë në të cilën është bërë edhe tërheqja e saj. Këto të ardhura të saj, të cilat kanë ekzistuar dhe janë realizuar para se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, të ishte emëruar në detyrën e gjyqtares, vlerësoj se duhet të konsiderohen në një vlerësim të përgjithshëm, nëse nëna e subjektit kishte apo jo mundësinë të krijonte shumën e dhënë hua me burime të ligjshme, duke konsideruar

avokatisë nr. 7541, datë 18.12.1991, i ndryshuar, në nenin 14 të tij përcaktonte se juristët që ushtrojnë profesionin e avokatit duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e avokatëve në Ministrinë e Drejtësisë.

¹⁰² *Meqenëse nga shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore {***} nr. {***} prot., datë 08.02.2018, rezultojnë të dhëna mbi fitimin e deklaruar nga babai i subjektit të rivlerësimit për vitet 1999-2002 (në vlerën totale prej 2.646.650 lekësh) është marrë mesatarja e këtyre viteve (2.646.650 lekë / 4 vite = 661.662 lekë) dhe është përdorur për të llogaritur të ardhura të përafërta për vitet 1996, 1997, 1998, duke aplikuar (marrë si të ardhur) masat 60% deri në 80% të kësaj mesatareje. Sipas kësaj metodologjie, nga përllogaritja ka rezultuar: për vitin 1996, në masën 60% të të ardhurave mesatare, e përllogaritur vetëm për gjysmën e dytë të vitit, pas regjistrimit në organet tatimore: $60\% \times 661.662 \text{ lekë} : 2 = 198.498 \text{ lekë}$; për vitin 1997, në masën 70% të të ardhurave mesatare e përllogaritur: $70\% \times 661.662 \text{ lekë} = 463.163 \text{ lekë}$; për vitin 1998, në masën 80% të të ardhurave mesatare, e përllogaritur: $80\% \times 661.662 \text{ lekë} = 529.330 \text{ lekë}$. Në total, sipas metodologjisë së mësipërme, rezulton të ketë pasur fitim për periudhën 1996-1998 përafërsisht 1.190.991 lekë.*

gjithmonë këtë fakt në kontekst të analizës së mësipërme për të ardhurat e babait të subjektit të rivlerësimit.

18. Përpos këtyre të dhënave, mendoj që duhet mbajtur në konsideratë edhe ekzistenca e një dokumenti, deklarata noteriale e shtetasit H.B., sipas së cilës në vitin 2013¹⁰³ ai i ktheu nënës së subjektit të rivlerësimit huan e marrë në vitin 2006, në shumën prej rreth 4.000.000 lekësh dhe fakti që, nga hetimi administrativ i kryer në Komision, është pranuar se ky shtetas kishte mundësi financiare për t'i thyer këto para.
19. Në analizën për aftësinë financiare të personit tjetër të lidhur, mendoj se nuk mund të bëhej pjesë analiza e parave të humbura në firmat piramidale, për sa kohë që ky moment nuk ka qenë pjesë e hetimit apo debatimit (personat e lidhur mund të kenë humbur, por edhe të kenë fituar në këto firma, çështje mbi të cilat Kolegji nuk ka informacion), për pasojë duket se nëpërmjet konsiderimit të këtij fakti, situata financiare e tyre rëndohet në mënyrë të padrejtë.
20. Përveç sa më sipër, duhet të konsiderohet edhe fakti se nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që të tregojë se personi tjetër i lidhur apo babai i subjektit të rivlerësimit kanë qenë të përfshirë në veprimtari të kundërligjshme që të mund të krijojnë të ardhura nëpërmjet këtij aktiviteti dhe të cenonin standardin e burimit të ligjshëm të pasurisë, të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 4 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.
21. Në përfundim të analizës së tyre, anëtarët e tjerë të trupës gjyquese kanë pranuar se personi tjetër i lidhur, znj. E.B., ka pasur mundësi për të dhuruar vetëm 555.637 lekë nga 1.800.000 lekë që pretendon subjekti. Ky konkluzion i nxjerrë në analizë të disa të dhënave, por jo të çdo të dhëne e vlerësim të çdo informacioni që do të mundësonte arritjen e një rezultati objektiv, pikërisht sepse kjo është e pamundur për personat e tjerë të lidhur, mendoj se afekton padrejtësisht analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.
22. Për sa më sipër, këto të dhëna, të analizuara në një dimension më të gjerë dhe me qasjen e përshkruar më lart, do të çonin në konkluzionin se personi tjetër i lidhur, nëna e subjektit të rivlerësimit, kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme shumën prej 1.800.000 lekësh dhe gjithashtu t'ia dhuronte atë subjektit të rivlerësimit. Ky konkluzion nuk do të cenonte vendimin e trupës gjyquese për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, duke qenë se mungesa e burimeve të ligjshme të dala nga analiza financiare për vetë subjektin, rezultonte përsëri e lartë dhe e pajustificueshme për llogari të këtij procesi, në zbatim të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

II

¹⁰³ Në dosje gjendet gjithashtu deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., e datës 04.04.2013, nënshkruar nga znj. E. B. dhe shtetasi H. B.. Me anë të këtij akti noterial, deklaruesit kanë pranuar se z. H. B., më datë 04.06.2006, i ka marrë borxh verbalisht znj. E. B. shumën 4.000.000 lekë për të kryer investime në hotel-restorant "{***}". Në datën 31.05.2011 i ka kthyer cash znj. E. B. këstin e parë të huas, në shumën 1.500.000 lekë, kurse më datë 04.04.2013, i ka kthyer cash, jashtë zyrës noteriale edhe këstin e dytë dhe të fundit të huas, në shumën 2.500.000 lekë.

23. Kam ndarë mendim të ndryshëm me anëtarët e tjerë të trupës gjykuese edhe për sa i përket konkluzionit se fakti që subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vitet 2014 dhe 2015, për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet, e bën atë të konsiderohet se ka kryer deklarim të rremë, sikurse parashikon neni 33, pika 5, germa “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016. Përveç faktit se kemi të bëjmë me një deklarim të bërë në deklaratat periodike, në vlerësimin tim situata faktike e deklarimit të rremë lidhet me deklaratimet apo tregimin në deklaratën *vetting* të të dhënave të pavërteta apo të rreme, për të cilat arrihet në këtë konkluzion, pasi pavërtetësia e tyre provohet me ekzistencën e të dhënave të tjera që konfirmojnë të kundërtën.
24. Në nenin 38 të ligjit nr. **9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar** parashikohet koncepti i deklarimit të rremë sipas të cilit: *Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën veprë penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa në ligjin nr. 84/2016 përkufizimi i nenit 33, pika 5, germa “ç” duhet të shihet i lidhur me përcaktimin e bërë në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon: Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.*
Në kuptimin penal, neni 257/a i Kodit Penal parashikon: *Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.*
25. Sa më sipër, parashikimi kushtetues është ai që tregon elementet përbërëse të deklarimit të rremë, për efekt të këtij procesi, sipas të cilit përcaktohet si deklarim i rremë çdo deklarim i subjektit të rivlerësimit që tenton të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të saj, i realizuar në zbatim të procesit të rivlerësimit, i mbështetur në të dhënat e rreme ose të pasakta të ofruara prej subjektit, të manipulojë rezultatin e këtij kontrolli e të çojë në lajthim organet e rivlerësimit të cilat për shkak të këtyre të dhënave, të konkludojnë se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë në pronësi të tij e të personave të lidhur sipas kriterit kushtetues, të parashikuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, e cila përcakton: *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.*
26. Sipas këtyre parashikimeve, deklarimi i rremë është një nga mënyrat e deformimit të deklaratimeve për të cilat ndëshkohet disiplinarisht subjekti i rivlerësimit, por gjithsesi mbetet në çdo rast një mjet që përdoret për të tentuar justifikimin e burimit të ligjshëm të pasurive.

Konkluzioni mbi këto rrethana duhet të vijë normalisht pas konstatimit të situatave apo fakteve të kundërta me ato që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit.

27. Në vlerësimin tim, konstatimi i një mungese të burimeve financiare të ligjshme, si pasojë e një analize financiare në të cilën ndërthuren vlerësime e qëndrime ligjore të organeve të rivlerësimit, por edhe vlerësime subjektive apo interpretative që vijnë si pasojë e procesit të analizimit e vlerësimit të provave, prodhon një rezultat apo të dhënë që i shërben pikërisht konkluzionit nëse subjekti ka pasur ose jo burime të ligjshme për të krijuar një pasuri, por jo verifikimit të deklarimeve të tij.
28. Për këto arsye, çmoj se Aneksi i Kushtetutës edhe ligji nr. 84/2016 kanë parashikuar këto dy situata faktike: mungesën e burimeve të ligjshme dhe deklarimin e rremë, si rrethana apo kritere më vete që shërbejnë për të konstatuar deklarimin e pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
29. Në rastin konkret, diferenca negative, e konstatuar për vitet 2014 e 2015, është përdorur si një rrethanë fakti për të dyja cilësimet, edhe si mungesë e burimeve të ligjshme, edhe si deklarim i rremë, duke konsistuar në një vlerësim të gabuar të kualifikimit ligjor, sipas vlerësimit tim.

Përfundimisht, mendoj se kjo situatë do të duhej të vlerësohej vetëm si mungesë e burimeve të ligjshme financiare, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit, nr. 84/2016.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi